

## **GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**

**P.nr. 12/2012**

**8 Mars 2013**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Nuno de Madureira Kryetar, Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa dhe Gjyqtarja e EULEX-it Katja Dominik, me Zyrtarin ligjor të EULEX-it John Gayer si procesmbajtës në lëndën penale kundër:

**MK, BK dhe EK**, të akuzuar sipas Aktakuzës së ndryshuar të Prokurorit Publik PP. 102/2011 të datës 31 Janar 2012 dhe të ndryshuar më 27 Nëntor 2012 dhe 3 Janar 2013 dhe të ushtruar në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës të datës 5 Mars 2012 për bashkë-kryerje në vrasjen e rëndë nga Neni 147(1), (5) dhe (11) të Kodit Penal të Kosovës (KPK); dhe bashkë-kryerje në vrasje të rëndë në tentativë nga Neni 147(1) dhe (5) i KPK. **MK** dhe **EK** gjithashtu akuzohen për Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të armëve nga Neni 328(2) i KPK.

*Pas* mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur për publik më 27 dhe 30 Nëntor, 3 dhe 5 Dhjetor, 15, 18 dhe 21 Janar 2013 gjithnjë në prani të të akuzuarve **MK, BK** dhe **EK**, Avokatëve Mbrojtës Xhelal Hasani, Rexhep Kaçaniku, dhe Agim Lushta; Palës së Dëmtuar **FK**, Përfaqësuesit të autorizuar të Palës së Dëmtuar Vahide Badivuku deri më 15 Janar dhe Halil Derguti nga data 15 Janar; dhe Prokurorit Publik të EULEX-it Maarten Groothuizen,

*Pas* këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur ndërmjet datave 18 dhe 21 Janar 2013,

*Sipas* Nenit 392(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpallur publikisht dhe në prani të të Akuzuarit, Avokatit të tij Mbrojtës, Palës së Dëmtuar, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palës së Dëmtuar dhe të Prokurorit Publik të EULEX-it

*nxjerr këtë :*

## **AKTGJYKIM**

### **I. Pika 1**

#### **Të Pandehurit:**

**MK,** i biri i

i arrestuar më 6 Gusht 2011 dhe në paraburgim nga data 8 Gusht 2011.

**BK,** i biri i

i arrestuar më 6 Gusht 2011 dhe në paraburgim nga data 8 Gusht 2011.

**EK,** (i njohur gjithashtu edhe si “ ”) i biri i

i arrestuar më 7 Gusht 2011 dhe në paraburgim nga data 8 Gusht 2011.

### **SHPALLEN FAJTORË**

**Sepse** është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më 6 Gusht 2011 **IK** ka udhëtuar për në fshatin në komunën e Vushtrrisë me bijën e tij vjeçare **AK**, dhe djalin vjeçar **AK2**.

**IK** kishte qenë i izoluar nga fshati për shkak të një kontesti me familjen e të Pandehurve. Ishte arritur një marrëveshje në komunitet që **IK** të largohej nga fshati në mënyrë që të zgjidhet mosmarrëveshja. Më 5 Gusht 2011 **IK** dhe **MK** ishin përfshirë në një grindje verbale lidhur me praninë e **IK** në fshat. **IK** iu kishte kërcënuar **MK** gjatë grindjes.

Më 6 Gusht 2011 **BK** kishte parë **IK**, **AK** dhe **AK2** që po hynin në fshat në një motokultivator me rimorkio rreth orës 11:00. Ai kishte kontaktuar me babën e tij, **MK**. **MK** e kishte ditur se **IK** rregullisht vizitonte një vend afër lumit Llap. **MK** dhe **BK** kishin vendosur për t'ia zënë pritën **IK**. **BK** kishte kontaktuar vëllain e tij **EK** për ta rregulluar punën që **EK** t'i transportonte të tre të Akuzuarit afër lumit Llap.

**MK** dhe **BK** kishin qenë te shtëpia e **MK** kur kishte arritur **EK** me veturën e tij, Audi 80 me ngjyrë të bardhë (numri i regjistrimit 02-560-AJ). **EK** ishte informuar për qëllimet e tyre dhe ishte pajtuar që t'i transportonte ata. **MK**, i armatosur me një pushkë automatike Crvena Zastava (nr. serik 0-81383), ishte ulur në ulësen e prapme pranë **BK** ndërsa **EK** po ngiste veturën. **BK** dhe **EK** e kanë ditur dhe e kanë pranuar se babai i tyre ishte i armatosur.

**EK** i kishte dërguar me veturë babën e tij (**MK**) dhe vëllain (**BK**) deri te udha që shpie te lumi Llap. Në këtë vend **MK** dhe **BK** kishin dalë nga vetura dhe kishin ecur në drejtim të lumit Llap. **EK** kishte pritur pak në veturë dhe pas pak iu kishte bashkangjitur atyre.

**MK**, **BK** dhe **EK** ia kishin zënë pritën **IK** rreth orës 14:00 kur ai po vinte rrugës duke u kthyer nga lumi Llap. Vajza e **IK** **AK** dhe djali **AK2** ishin ulur në rimorkio mu pas tij, njëri në njëerën anë e tjetri në anën tjetër. **MK** kishte hapur zjarr pa bërë dallim dhe pa paralajmërim. Nën zjarrin e qëndrueshëm **MK** ka qëlluar dhe vrarë **IK** dhe **AK**. Ai gjithashtu e ka plagosur **AK2** në qafë.

**EK** kishte intervenuar pasi ishte vrarë **IK** për t'ia marrë armën **MK** i cili akoma po qëllonte me armë.

Duke vepruar kështu **MK** me dashje ka vrarë **IK** në të njëjtën kohë kur ka qëlluar dhe ka vrarë **AK** vjeçare. Ai e ka ditur se duke shtënë në kishte rrezik substancial që ta qëllonte dhe vriste vajzën dhe djalin por nuk ka ndërmarrë asnjë hap për ta shmangur këtë. Ai kreu të shtënat.

**BK** dhe **EK** kanë vepruar në mënyrë vullnetare bashkë me babën e tyre dhe në dijëni të plotë për planin e zënies së pritës dhe vrasjes së **IK**.

**MK, BK** dhe **EK** kanë qenë plotësisht të aftë mendor.

**Prandaj,**

**I Pandehuri MK DËNOHET** për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë të **IK** nga Nenet 23 dhe 147(11) të Kodit Penal të Kosovës –/RREG/ UNMIK/2003/25 KPK), në përputhje me Nenin 2(1), të KPK;

**I Pandehuri MK DËNOHET** për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë të **AK** nga Neni 147(1) dhe (11) KPK, në përputhje me Nenin 2(1), të KPK;

**I Pandehuri BK DËNOHET** për kryerjen e veprës penale vrasje të **IK** nga Nenet 23 dhe 146 të KPK, në përputhje me Nenin 2(1), të KPK;;

**I Pandehuri EK DËNOHET** për kryerjen e veprës penale vrasje të **IK** nga Nenet 23 dhe 146 të KPK, në përputhje me Nenin 2(1), të KPK; sipas Nenit 388(1) të KPPK.

## **II. Të Pandehurit BK dhe EK**

### **SHPALLEN TË PAFAJSHËM**

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se, megjithëse **BK** e dinte se **AK** ishte me **IK**, ajo ishte shënjestër e menduar dhe se **BK** ka paraparë dhe pranuar se veprimet e **MK** do të rezultojnë me vdekjen e saj.

Gjithashtu, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **EK** ishte në dijeni për praninë e **AK** me babain e saj para se t'i dërgonte të Akuzuarit në vendin e krimit dhe se ai kishte pranuar që ajo të ishte shënjestër e menduar ose që ishte parashikuar që veprimet e **MK** do të rezultonin në vdekjen e saj.

**Prandaj, të Pandehurit BK dhe EK LIROHEN** nga akuza për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë e **AK** (Neni 147(1),(5) dhe (11), lidhur me nenin 23 të KPK), sipas Nenit 390(3) KPPK.

### **III. Pika 2**

**I Pandehuri MK** gjithashtu

#### **SHPALLET FAJTOR**

**Për shkak të** fakteve të vërtetuara nga Pika 1.

Përveç kësaj **MK** ka vazhduar të qëllojë në **AK2** gjersa ai po largohej nga vendngjarja.

**Duke** vepruar kështu **MK** me dashje ka qëlluar dhe plagosur **AK2** me qëllim që ta vriste atë.

**Prandaj,**

**I Pandehuri MK DËNOHET** për kryerjen e veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë nga Nenet 20 dhe 147(1) të KPK, në pajtim me Nenin 2(1), të KPK; sipas Nenit 388(1) të KPPK.

### **IV. Të Pandehurit BK dhe EK**

#### **SHPALLEN TË PAFAJSHËM**

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se, megjithëse **BK** e dinte se **AK2** shoqëronte babën e tij, është pajtuar dhe ka pranuar për ta vënë **AK2** në shënjestër apo ka paraparë në mënyrë të mjaftueshme dhe ka pranuar se veprimet e **MK** mund të rezultojnë në vrasjen e **AK2**.

Gjithashtu, nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **EK** e ka ditur që **AK2** e shoqëronte babën e tij para se ai t'i dërgonte të Akuzuarit në vendngjarje apo se është pajtuar apo ka pranuar për ta vënë në shënjestër **AK2** apo se ka paraparë dhe pranuar që veprimet e **MK** mund të rezultojnë në vrasjen e **AK2**.

**Prandaj, të Pandehurit BK dhe EK LIROHEN** nga akuza për kryerjen e veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë të **AK2** (Nenet 147(1), (5) dhe (11), lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK), sipas Nenit 390(3), KPPK.

#### **V. Pika 3**

#### **Të Pandehurit MK dhe EK**

### **SHPALLEN FAJTORË**

**Sepse MK** deri më 6 Gusht 2011, në shtëpinë e tij në fshatin \_\_\_\_\_, Vushtrri, ishte në posedim të një pushke automatike Crvena Zastava (nr. serik 0-81383) e kalibrit 7.62. Më 6 Gusht 2011 ai e ka sjellë armën në vendin e krimit dhe e ka përdorur atë.

Në vendin e krimit **EK** mori armën nga babai i tij. Ai vazhdoi ta fsheh armën afër lumit Llap. Më vonë ai e dërgoi policinë në vendin ku e kishte fshehur armën.

As **MK** as **EK** nuk kishin lejet e nevojshme për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të armës.

**Duke** vepruar kështu **MK** mbante armën nën kontroll dhe posedim të paautorizuar. **EK** ishte në posedim të paautorizuar të armës gjersa e kishte fshehur atë.

**Prandaj,**

**Të Pandehurit MK dhe EK secili DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll apo posedim të armëve nga Neni 374(1) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Nr. i Kodit. 04/L-082) në përputhje me Nenin 2(2) të KPK; sipas Nenit 388(1) të KPPK.

**VI. Në përputhje me Nenin 388(1) të KPPK të Akuzuarit**

### **DËNOHEN**

si në vijim:

#### **Pika 1**

- Sipas Neneve 2(1) dhe 147(11) të KPK dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK:

**MK** dënohet me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim për vdekjen e **IK**;

- Sipas Neneve 2(1) dhe 147(1) dhe (11) të KPK dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK:

**MK** dënohet me 17 (shtatëmbëdhjetë) vjet burgim për vdekjen e **AK**;

- Sipas Neneve 2(1) dhe 146 I KPK dhe në përputhje me Nenin 38 të KPK:

**BK** dënohet me 9 (nëntë) vjet burgim;

**EK** dënohet me 7 (shtatë) vjet burgim.

#### **Pika 2:**

- Sipas Neneve 2(1) dhe 147(1) dhe (11) të KPK dhe në përputhje me Nenet 20(3), 38 dhe 65(2) të KPK:

**MK** dënohet me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.

#### **Pika 3:**

- Sipas Neneve 2(2) të KPK dhe Nenit 374(1) të KPRK dhe në përputhje me Nenin 45(1) dhe (2) KPRK:

**MK** dënohet me 3 (tre) vjet burgim.

**EK** dënohet me 2 (dy) muaj burgim.

#### **VII. Dënimi unik**

Në përputhje me Nenin 71(2)(2) të KPK, shqiptohet ky dënim unik:

- **MK** dënohet me 20 (njëzet) vjet burgim;

- **EK** dënohet me 7 (shtatë) vjet e 1 (një) muaj burgim.

**Koha e kaluar në paraburgim nga të Pandehurit do të llogaritet në përputhje me Nenet 73(1) të KPK dhe 83(1) të KPRK; si dhe me Nenin 71(2)(1) të KPK.**

**VIII.** Në pajtim me Nenin 374 (3) të KPRK, pushka automatike Crvena Zastava (nr. serik 0-81383) dhe municioni i sekuestruar konfiskohen.

**IX.** Në pajtim me Nenin 60(1) të KPK vetura Audi me numër të regjistrimit. 02-560-AJ konfiskohet.

**X.** Të Akuzuarit **MK**, **BK** dhe **EK** do të paguajnë nga 400 (katërqind) Euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale, por lirohen nga detyrimi për të kompensuar shpenzimet tjera në pajtim me Nenin 102 paragrafët (1) dhe (4) KPPK. Të Akuzuarit duhet ta paguajnë shumën e urdhëruar jo më vonë se 30 ditë nga dita kur ky Aktgjykim të bëhet I formës së prerë.

**XI.** Palët e Dëmtuara udhëzohen se mund t'i ndjekin kërkesat pasurore në kontest civil sipas Nenit 112 (2) i KPPK.

**ARSYETIM**



## **1. Historia Procedurale**

1. Prokurori Publik i Qarkut të Mitrovicës ka paraqitur një Aktakuzë PP.no 102/2011 të datës 31 Janar 2012, me të cilën akuzohen të gjithë të Akuzuarit për bashkë-kryerje të vrasjes së rëndë nga Nenet 23 dhe 147(9) dhe (11) të KPK dhe bashkë-kryerje të vrasjes së rëndë në tentativë nga Nenet 20, 23 dhe 147(1) të KPK. **MK** dhe **EK** më tej akuzohen për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga Neni 328(2) i KPK.

2. Më 27 Nëntor 2012 dhe 2 Janar 2013 Aktakuza është ndryshuar si në vijim. Elementi i hakmarrjes është larguar nga Aktakuza dhe është zëvendësuar me karakteristikën rënduese i pamëshirshëm dhe i dhunshëm. Koha e veprës në Aktakuzë është specifikuar ndërmjet orës 10.00 dhe 14.00 me 6 Gusht 2011. Pika një e Aktakuzës është ndryshuar në akuzën nga Nenet 23 dhe 147(1), (5) dhe (11) të KPK. Pika dy e Aktakuzës është ndryshuar në Nenet 147(1) dhe (5) të KPK. Përveç kësaj, për të reflektuar hyrjen në fuqi të kodit të ri penal- Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)- janë shtuar referenca të reja nga KPRK. Këto janë Nenet 31 dhe 179(1.1), (1.5) dhe (1.11) të KPRK për pikën një të Aktakuzës dhe Nenet 28, 31 dhe 179(1.1) dhe (1.5) të KPRK për pikën dy të Aktakuzës.

3. Më 30 Gusht 2012 Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it lëndën ua ka caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it në pajtim me Nenin 3.3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

4. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 27 dhe 30 Nëntor, 3 dhe 5 Dhjetor 2012, 15, 18 dhe 21 Janar 2013. Aktgjykimi është shpallur më 21 janar 2013 në pajtim me dispozitivin e lartcekur.

## **2. Kodi i Procedurës**

5. Më 1 Janar 2013 ka hyrë në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale në Kosovë. Kodi i Procedurës Penale (Nr. Penal 04/L-123) (KPP) ka zëvendësuar Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale ( të ndryshuar) (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26) (KPPK) (Nenet 545(2) dhe 547 të KPP). Dispozitat kalimtare dhe të ruajtjes zbatohen të cilat përcaktojnë zbatimin e procedurës sipas KPP dhe vazhdimin e zbatimit të KPPK në rrethana specifike. Pasi që Aktakuza është konfirmuar me një vendim të formës së prerë para datës 1 Janar 2013, Neni 541(2) i KPP përcakton përdorimin e KPP apo të KPPK. Trupi Gjyqësor konsideron se fushëveprimi i Neni 541(2) nuk është menduar të përfshijë shqyrtimet gjyqësore në vazhdim e sipër që kanë filluar para datës 1 janar 2013 dhe KPPK duhet të vazhdojë të zbatohet së pakut deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

6. Kjo është konfirmuar nga një mendim ligjor nr. 56/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 23 Janar 2013 me të cilin ndryshohet mendimi ligjor nr. 93/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 7 Janar 2013. Këto mendime ligjore diskutojnë vetëm shqyrtimet gjyqësore që janë në vazhdim e sipër.

7. Këto procedura kanë kaluar nga faza e shqyrtimit gjyqësor në fazën e mjeteve juridike siç përcaktohet nga Neni 68 i KPP. Si e tillë kjo fazë e procedurës rregullohet nga KPP dhe jo nga KPPK në pajtim me Nenin 541(2) të KPP pasi që Aktakuza është konfirmuar. Sipas Nenit 541(2) të KPP procedura duhet të përmbillet sipas KPP, edhe pse Trupi Gjykes konsideron se ligjshmëria e çdo procedure duhet të vlerësohet në dritën e KPPK që ishte duke u zbatuar në atë kohë. Trupi Gjykes vë re se të drejtat themelore të mbrojtjes kanë ruajtur mbrojtjen e njëjtë kushtetuese pavarësisht a zbatohet KPPK apo KPP.

### **3. Kompetenca**

8. Ligji mbi Gjykatat, Ligji nr. 03/L-199 (LC) gjithashtu ka hyrë plotësisht në fuqi më 1 Janar 2013 (Neni 43). Ky rregullon kompetencën territoriale dhe lëndore të Gjykatës.

9. Veprat bien në kompetencën territoriale dhe lëndore të Gjykatës Themelore të Mitrovicës (para datës 1 Janar 2013 Gjykata e qarkut të Mitrovicës). Veprat vrasje e rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë kanë dënimin prej së pakut 10 vjet burgim dhe bien në kompetencë lëndore të Gjykatës Themelore të shkallës së parë (shiko Nenin 23(1)(i) të KPPK dhe Nenin 15(1.11) dhe (1.21) të LGj). Pasi që vepra është kryer në Komunën e Vushtrrisë, kjo bie nën kompetencën territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sipas Nenit 27(1) të KPPK dhe Nenit 9(2.7) të LGj.

### **4. Ndryshimi në përbërjen e trupit gjykes**

10. Në fillim të gjykimit më 27 Nëntor 2012 Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Karpati ishte anëtare trupit gjykes. Ajo është zëvendësuar nga Gjyqtarja e EULEX-it Katja Dominik nga data 30 Nëntor 2012 e tutje deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Gjyqtarja Karpati ishte në dispozicion vetëm më 13 Dhjetor 2012 pas së cilës datë ajo e ka lëshuar Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës në fund të vitit. Më 27 Nëntor 2012 një vlerësim mjekësor për është konsideruar i nevojshëm për të vlerësuar aftësinë e tij mendore. Raporti nuk ka qenë gati deri në fund të vitit 2012 dhe është bërë gati më 11 Janar 2013.

11. Në pajtim me Nenin 345(1) të KPPK procedura e datës 27 Nëntor 2012 është konsideruar si e lexuar për Trupin Gjykes në përbërjen e tij të ndryshuar.

### **5. Aftësia mendore e MK**

12. Në bazë të vlerësimit mjekësor të **MK** të datës 11 Janar 2013, Trupi Gjykes konsideron se ai ishte mendërisht i aftë për veprën dhe i përshtatshëm për të qëndruar në gjykim. Kjo është shpallur më 18 Janar 2013.

### **6. Provat në gjykim**

13. Provat në vijim janë konsideruar sit ë pranueshme në shqyrtimin gjyqësor:

14. Raportet policore në vijim:

- Kallëzimet Penale të datave 6 dhe 7 Gusht 2011,
- Raporti i Policit Sevet Sadiku (#5377) i datës 6 Gusht 2011,
- Raporti i Policit Abdylaziz Hoxha (#0249) i datës 6 Gusht 2011, dhe
- Memot e Policit Fadil Gashi të datës 7 Gusht 2011.

15. Të dhënat në vijim nga intervistat e dëshmitarëve:

- Të dhënat nga intervista e **AK2** e datës 6 Gusht 2011,
- Të dhënat nga intervista e **FK** e datës 6 Gusht 2011.
- Të dhënat nga intervista e **LH** e datës 6 Gusht 2011,
- Të dhënat nga intervista e **RM** e datës 6 Gusht 2011,
- Të dhënat nga intervista e **NH** e datës 6 Gusht,
- Të dhënat nga intervista e **KM** e datës 6 Gusht,
- Të dhënat nga intervista e **AK2** e datës 7 Gusht, dhe
- Të dhënat nga intervista e **MA** e datës 8 Shtator 2011.

16. Procesverbalet e intervistave të këtyre të dyshuarve dhe të pandehurve:

- Procesverbali nga intervista e të dyshuarit **MK** e datës 7 Gusht 2011,
- Procesverbali nga intervista e të dyshuarit **BK** e datës 7 Gusht 2011,
- Procesverbali nga intervista e të dyshuarit **EK** e datës 7 Gusht 2011,
- Procesverbali nga intervista e të dyshuarit **EK** e datës 2 Shtator 2011,
- Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **BK** e datës 6 Shtator 2011,

- Procesverbali nga intervista e të Pandehurit **MK** e datës 29 Shtator 2011 dhe procesverbali nga intervista e të Pandehurit **MK** e datës 26 tetor 2011.

17. Raportet dhe urdhrat e ndryshëm në vijim:

- Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për VALA për zbulimin e të dhënave telefonike i datës 9 Gusht 2011,
- Memorandum nga Polici i PK Fadil Gashi i datës 10 Gusht 2011
- Urdhër i Prokurorit Publik për VALA i datës 10 Gusht 2011,
- Raport nga PTK i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44384325 (dalje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44384325 (hyrje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44586821 (dalje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44586821 (hyrje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 45268940 (dalje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 45268940 (hyrje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44469443 (dalje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44469443 (hyrje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44967409 (dalje) i datës 15 Gusht 2011,
- Raport telefonik i PTK-së për nr. 44967409 (hyrje) i datës 15 Gusht 2011,
- Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës ) i datës 8 Gusht 2011,
- Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës ) i datës 10 Gusht 2011,
- Urdhri i Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës ) i datës 20 Janar 2012,
- Kërkesë e Prokurorit Publik e datës 10 Gusht 2011,
- Kërkesë e Prokurorit Publik e datës 10 Gusht 2011,
- Kërkesë e Prokurorit Publik e datës 17 Janar 2012,
- Lista e gjësendeve të kthyera e datës 17 janar 2012,
- Procesverbal nga bastisja e shtëpisë së **MK** i datës 6 Gusht 2011,
- Raport nga tërheqja e veturës i datës 6 Gusht 2011,
- Lista e gjësendeve të sekuestruara të **EK** e datës 7 Gusht 2011,
- Dëftesë e sendeve të konfiskuara nga **NH** pa datë,
- Skicë e pidentifikuar e vendngjarjes e datës 8 gusht 2011,
- Skicë e vendngjarjes nga **AK2** e datës 30 Nëntor 2012,
- Certifikata e vdekjes e **MA**,
- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **MK** e datës 23 Nëntor 2012,

- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **BK** e datës 23 Nëntor 2012,
- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **EK** e datës 23 Nëntor 2012,
- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **MK** nga Gjykata Komunale në Vushtrri e datës 15 Nëntor 2012,
- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **BK** nga Gjykata Komunale në Vushtrri e datës 15 Nëntor 2012, dhe
- Kontrollimi i së kaluarës kriminale të **EK** nga Gjykata Komunale në Vushtrri e datës 15 Nëntor 2012.

18. Raportet e forensikës dhe ekspertit si në vijim:

- Format A dhe B të Laboratorit të Forensikës të datë 6 Gusht 2011,
- Raporti i Qendrës Shkencore Forensike të Kroacisë i datës 8 Mars 2012,
- Raporti i hetimit të vendngjarjes nga policët e PK Arta Ferati (#1782) dhe Rreshter Petrit Fejza i datës 8 Gusht 2011,
- Lista e provave nga Polici i PK Besim Osmani (#0761) e datës 10 Gusht 2011,
- Lista e provave nga Polici i PK Arta Ferati (#1782) e datës 8 Gusht 2011,
- Format e Qendrës Laboratorike të Forensikës A e datës 6 Gusht 2011, C e datës 10 dhe 12 Gusht 2011 dhe 12 Janar 2012, dhe D pa datë,
- Procesverbali nga hyrja në vendngjarje- pa datë,
- Raportet e ekspertizës nga Njësia e Ekspertizës së Armëve të Zjarrit, të datave 22 dhe 23 Gusht 2011,
- Raporti i ekspertizës nga Sektori për gjurmë dhe daktiloskopi i datës 16 Gusht 2011,
- Raporti përmbledhës i Autopsisë i **IK** dhe **AK** nga Polici i PK Besim Osmani (#0761) i datës 9 Gusht 2011,
- Legjenda e skicës e datës 6 Gusht 2011,
- Matjet,
- Skica e vendngjarjes,
- Fotografi nga autopsia e **IK** dhe **AK**,
- Fotografi të vendngjarjes nga polici i PK i Njesisë së Forensikës Sead Azemi (#0192) të datës 6 Gusht 2011,
- Fotografi të vendngjarjes nga policja PK e Njesisë së Forensikës Arta Ferati (#1782) të datës 7 Gusht 2011,
- Raporti mjekësor i **MK** nga Klinika Psikiatrike e QKUK-së i datës 11 Janar 2013,
- Autopsia e **IK** e datës 8 Gusht 2011,
- Raporti i Autopsisë së **AK** i datës 8 Gusht 2011, dhe

- Raporti mjekësor i **AK2** i datës 6 Gusht 2011.

19. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhanë deklaratat këta dëshmitarë:

- **FK** më 30 Nëntor 2012,
- **AK2** më 30 Nëntor 2012,
- **RM** më 3 Dhjetor 2012,
- **KM** më 3 Dhjetor 2012,
- **NH** më 3 Dhjetor 2012,
- **LH** më 3 Dhjetor 2012,
- **AK** më 5 Dhjetor 2012, dhe
- **BA** më 15 Janar 2012.

20. **MK** dhe **BK** kanë dëshmuar më 15 Janar 2013. **EK** e ka ushtruar të drejtën për të mos u përgjigjur në pyetje por ka konfirmuar deklaratat e dhëna para shqyrtimit gjyqësor në polici dhe te prokurori.

21. Gjatë gjykimit janë bërë këto propozime për prova nga palët dhe janë refuzuar nga Trupi Gjyqësor:

- Më 27 Nëntor 2012 Përfaqësuesi i Autorizuar i Palës së dëmtuar ka dorëzuar emrat e tre dëshmitarëve që Pala e Dëmtuar dëshironte t'i thërrasë. Trupi Gjyqësor ka refuzuar propozimin e datës 30 Nëntor 2012 si të panevojshëm nga Neni 152(3) (1) i KPPK. Elementi i hakmarrjes i prokurorisë ka rënë gjë që i ka bërë dëshmitarët e propozuar të parëndësishëm.
- Më 27 Nëntor 2012 Avokati Mbrojtës i **EK** ka kërkuar një raport të balistikës dhe forensikës dhe rekonstruktimin e vendngjarjes. Trupi Gjyqësor ka refuzuar propozimet më 30 Nëntor 2012 si të panevojshme nga Neni 152(3) (1) i KPPK. Sa u përket raporteve të balistikës dhe forensikës sepse provat kanë qenë të qarta dhe për rikonstruktimin e vendngjarjes sepse ishte e paqartë se çka do të arrihej me këtë.
- Më 27 Nëntor 2012 Avokati Mbrojtës i **BK** ka kërkuar që të thirren dy dëshmitarë të emëruar dhe një dëshmitar i paidentifikuar, dhe të dhënat e PTK-së për telefonin e **BK**. Trupi Gjyqësor i refuzoi pjesërisht këto propozime më 30 Nëntor 2012 si të pamundura nga Neni 152(3)(3) i KPPK për dëshmitarin e paidentifikuar dhe si të panevojshme nga Neni 152(3)(2) i KPPK për

mbledhjen e të dhënave të PTK-së sepse ato nuk do të vërtetonin se **BK** ishte ai që kishte blerë kredinë e telefonit.

- Më 15 Janar 2013 Avokati Mbrojtës i **BK** kërkoi një ekspert për të përcaktuar përkufizimin e termave “mizorisht dhe dhunshëm”. Trupi Gjykses refuzoi këtë propozim sepse janë terma ligjor dhe janë në kompetencë të Trupit Gjykses. Nuk u kërkua asnjë ekspert.

22. NB: çdo referim i bëhet versionit në gj. angleze të deklaratave, raporteve, procesverbaleve nga shqyrtimi gjyqësor apo dokumenteve tjera nëse nuk nuk ceket shprehimisht.

## **7. Konstatimi i fakteve nga Gjykata**

### **7.1 Përmbledhje e fakteve të vërtetuara dhe të pavërtetuara**

#### **7.1. 1. Faktet në vijim janë vërtetuar:**

I. **IK** ishte izoluar nga fshati \_\_\_\_\_ për shkak të një mosmarrëveshje me familjen e të Pandehurve. Një marrëveshje ishte arritur në komunitet që **IK** të largohej nga fshati \_\_\_\_\_ që të zgjidhet mosmarrëveshja. Më 5 Gusht 2011 **IK** dhe **MK** ishin përfshirë në një grindje verbale lidhur me prezencën e **IK** në fshat. **IK** iu kishte kërcënuar **MK** gjatë grindjes.

II. Më 6 Gusht 2011 **IK** \_\_\_\_\_ kishte udhëtuar për në fshatin \_\_\_\_\_ në Komunën e Vushtrrisë me vajzën e tij \_\_\_\_\_ vjeçare **AK** dhe me djalin \_\_\_\_\_ vjeçar **AK2**.

III. Më 6 Gusht 2011 **BK** kishte parë **IK**, **AK** dhe **AK2** duke hyrë në fshat me një “moto-kultivator” me rimorkio rreth orës 11:00. Ai kishte kontaktuar babain e tij, **MK**. **MK** e dinte se **IK** rregullisht e vizitonte një lokacion afër lumit Llap. **MK** dhe **BK** ishin pajtuar t’i bënin pritë **IK**. **BK** kishte kontaktuar babain e tij **EK** që të rregullohet transporti për tre të Akuzuarit deri afër lumit Llap.

IV. **MK** ishte në posedim dhe kontroll të një armë automatike Crvena Zastava (nr. serik. 0-81383) e kalibrit 7.62 dhe me municion 7.62 x 39mm në shtëpinë e tij në fshatin \_\_\_\_\_, Vushtrri.

V. **MK** dhe **BK** ishin në te shtëpia e **MK** kur arriti **EK** me veturën e tij, Audi 80 ngjyrë të bardhë(nr. i regjistrimit 02-560-AJ). **EK** ishte informuar për qëllimet e tyre dhe ishte pajtuar t'i transportonte ata. **MK**, i armatosur me një pushkë automatike Crvena Zastava (nr. serik 0-81383), ishte ulur në ulësen e prapme pran **BK** derisa **EK** po ngiste veturën. **BK** dhe **EK** ishin në dijeni dhe kanë pranuar se babai i tyre ishte i armatosur.

VI. **EK** e kishte dërguar me veturë babain e tij (**MK**) dhe vëllain (**BK**) te rruga që çonte te lumi Llap. Në këtë vend **MK** dhe **BK** kishin dalë nga vetura dhe kishin ecur në drejtim të lumit Llap. **EK** i kishte pritur pak kohë në veturë dhe pastaj iu kishte bashkuar atyre.

VII. **MK**, **BK** dhe **EK** ia kishin zënë pritën **IK** rreth orës 14:00 gjersa ai po vinte rrugës duke u kthyer nga lumi Llap. Vajza e **IK**, **AK**, dhe djali **AK2** ishin ulur në rimorkio mu pas tij, në të dy anët e babait të tyre. **MK** kishte hapur zjarr pa dallim dhe pa paralajmërim. Nën zjarrin e vazhdueshëm **MK** kishte shtënë dhe vrarë **IK** dhe **AK**. Ai e kishte plagosur edhe **AK2** në qafë. Ai e kishte rimbushur armën me municion gjatë sulmit.

VIII. **MK** kishte vazhduar të shtie me armë zjarri në drejtim të **AK2** gjersa ai po largohej nga vendngjarja.

IX. **MK** me qëllim kishte shtënë dhe plagosur **AK2** me qëllim që ta vriste.

X. **MK** me qëllim e kishte vrarë **IK** dhe në të njëjtën kohë kur kishte shtënë kishte vrarë edhe **AK**. Ai e ka ditur se duke shtënë në **IK** kishte rrezik substancial që ai ta qëllonte dhe vriste vajzën dhe djalin por nuk ka ndërmarrë asnjë hap për t'iu shmangur kësaj. Ai kishte vazhduar të shtënat.

XI. **EK** kishte intervenuar pasi ishte vrarë **IK** dhe **AK** për ta marrë armën nga **MK** gjersa ai vazhdonte të shtie me armë.

XII. **EK** kishte shkuar ta fshihte armën afër lumit Llap. Më vonë ai kishte dërguar policinë në vendin ku e kishte fshehur armën.

XIII. **BK** dhe **EK** kishin vepruar vullnetarisht bashkë me babain e tyre dhe në dijeni të plotë për planin për t'ia zënë pritën dhe për ta vrarë **IK**.



XIV. **MK, BK** dhe **EK** ishin mendërisht plotësisht të aftë.

XV. As **MK** dhe as **EK** nuk kishin lejen e kërkuar për ta mbajtur në pronësi, kontroll apo posedim këtë armë.

#### **7.1.2. Nuk është vërtetuar , se:**

- Megjithëse **BK** e kishte ditur që **AK** ishte me babain e saj **IK**, ajo ishte në shënjestër dhe **BK** kishte paraparë se veprimet e **MK** do të rezultonin në vdekjen e saj;

- **EK** ishte në dijeni për prezencën e **AK** me babain e saj para se t'i dërgonte të Akuzuarit me veturë deri në vendngjarje dhe ai ka pranuar atë si shënjestër të menduar ose parashihej që veprimet e **MK** do të rezultonin në vdekjen e saj;

- Megjithëse **BK** e dinte se **AK2** e shoqëronte babain e tij, ai ishte pajtuar apo kishte pranuar të vë në shënjestër **AK2** apo kishte paraparë në mënyrë të mjaftueshme dhe kishte pranuar që veprimet e **MK** do mund të rezultonin në shtënie të **AK2**;

- **EK** e dinte se **AK2** e shoqëronte babain e tij para se t'i dërgonte të Akuzuarit në vendngjarje apo se ai ishte pajtuar apo kishte pranuar që ta vë **AK2** në shënjestër apo e kishte paraparë dhe ishte pajtuar që veprimet e **MK** do mund të rezultonin në shtënie të **AK2**.

#### **7.1.3. Faktet e pakontestueshme**

23. Një numër faktesh janë të pakontestueshme dhe prandaj të vërtetuara.

24. **IK** ishte gjykuar dhe ishte liruar nga vrasja e **GK** (djali i **MK** dhe vëllai i **BK** dhe **EK**). Me lirim të tij nga paraburgimi **IK** ishte izoluar nga fshati nga komuniteti pas një procesi në të cilin ishin përfshirë edhe familjet e të Pandehurve edhe të Viktimave. **IK** dhe **MK** kishin pasur një konfrontim ku kishin këmbyer kërcënime verbale më 5 Gusht 2011 (Dëshmia e **MK** në gjykim më 15 Janar 2013 (Gjykimi i **MK** ) në para. 316). Trupi Gjykes nuk konsideron se rrëfimi kontradiktor i **MK** se ku kishte ndodhur ky konfrontim –

në fshat apo te lumi Llap- minon rrëfimin e tij lidhur me konfrontimin (shiko intervistën e **MK** të datës 26 Tetor 2011 (**MK** i pandehur)).

25. **IK**, **AK** dhe **AK2** kishin udhëtuar bashkë nga për në te lumi Llap më 6 gusht 2011 rreth orës 11:00 (dëshmia e **AK2** gjatë gjykimit **AK** gjykimi) dhe dëshmia e **FK** gjatë gjykimit (gykimi **FK**) të dyja me datë 30 Nëntor 2012, para. 275 deri 292 respektivisht para. 48 deri 59 ; dhe intervista e dëshmitares **FK** e datës 6 gusht 2011 (**FK** dëshmitare)). **BK** ishte në Grace më 6 Gusht 2011 (**AK** gjykimi, para. 298 deri 350; dhe dëshmia e **AK3** e datës 5 Dhjetor 2012 (AvK gjykimi) para. 60 deri 65). **BK** konfirmon se ishte në në mëngjes (dëshmia e **BK** e datës 15 Janar 2013 (**BK** gjykimi), para. 515 dhe 516).

26. **EK** kishte shkuar në vendngjarje me veturë Audi ngjyrë të bardhë, me nr. regjistrimi 02-560-AJ (**EK** i pandehur, faqe 2).

27. Më tej **MK** i kishte zënë pritën dhe e kishte vrarë **IK** me një pushkë automatike (**MK** trial, para. 233 deri 242; **AK** gjykimi, para. 374; Intervista e të dyshuarit **EK** e datës 7 Gusht 2011 (**EK** i dyshuar), faqe 2 dhe intervista e të pandehurit **EK** e datës 2 Shtator 2011 (**EK** i pandehur), faqe 3). Së pakut 15 të shtëna janë shkrepur nga arma në bazë të gëzhgojave të gjetura në vendngjarje të cilat ishin të ngjashme me të shtënat testuese të armës Raporti i Njësisë për Ekspertizën e Armëve të Zjarrit i datës 22 Gusht 2011). E njëjta armë që e kishte vrarë **IK** e kishte vrarë edhe **AK** dhe e kishte plagosur **AK2** (Raporti i Qendrës Shkencore Forensike i datës 8 Mars 2012; Raportet e Njësisë për Ekspertizën e Armëve të datës 22 dhe 23 Gusht 2011; Raporti Mjekësor i **AK2** i datës 6 Gusht 2011; Raporti i Autopsisë i **IK** i datës 8 Gusht 2011; dhe Raporti i Autopsisë i **AK** i datës 8 Gusht 2011).

28. **MK** pranon se kishte marrë dy karikator me municion, edhe pse me gjasë karikatorët nuk ishin plot municion (**MK** i pandehur, faqe.2). Në çdo rast një karikator municioni është gjetur i zbrazur d.m.th. gjatë pritës **MK** ishte ndalur dhe e kishte rimbushur armën (Lista e provave e datës 8 Gusht 2011, dëshmitë B1.1 dhe B1.2; dhe **EK** i pandehur, faqe 3).

29. Pas arrestimit të tij **EK** e kishte dërguar policinë te arma dhe municioni (**EK** i dyshuar, faqe 2 dhe Lista e gjësendeve të Sekuestruara nga **EK** e datës 7 Gusht 2011, nr. 2 deri 4). Arma e vrasjes është një pushkë automatike Crvena Zastava M70 AB2 e kalibrit 7.62 x 39mm (numrat serik 81383 dhe 72394) e gjetur me 9 fishekë municion 7.62 me bërthama metalik dhe me mbështjellës të plotë metalik (Shiko raportet e Njësisë për Ekspertiza të Armëve të Zjarrit të datave 22 dhe 23 Gusht 2011, Lista e Provave e datës 8 Gusht 2011, dëshmitë B1 deri B1.2, dhe Fotoalbumin e datës 6 Gusht 2011, fotografitë 7, 8 dhe 10).

30. Prita kishte ndodhur ndërmjet orës 13.38 kur **FK** dhe **IK** kishin folur herën e fundit dhe orës 14.30 kur policia e kishte siguruar vendin e ngjarjes (raporti telefonik i PTK-së për nr. 44469443 (dalje) i datës 15 Gusht 2011; raporti telefonik i PTK-së për nr. 45268940 (dalje) i datës 15 Gusht 2011; dhe Procesverbali mbi hyrjen në vendngjarje pa datë).

31. **IK** është vrarë nga plagët e pësuar nga arma e zjarrit (Raporti i Autopsisë së **IK** i datës 8 Gusht 2011, faqe 16 deri 19). **AK** është vrarë nga plagët e pësuar nga arma e zjarrit në kokë (Raporti i Autopsisë së **AK** i datës 8 Gusht 2011, faqe 4). **AK2** ka plagë nga arma e zjarrit në qafë (raporti mjekësor i **AK2** i datës 6 Gusht 2011).

32. Fakti që **AK** dhe **AK2** ishin fëmijë në atë kohë është i pakontestueshëm dhe i vërtetuar.

#### **7.1.4. Faktet në kontest**

33. Trupi Gjykues mori në parasysh një numër faktesh të cilat ishin ose në mënyrë implicite ose në mënyrë eksplicite të kontestuara.

*A i kishte parë **BK** viktimat që ishin hyrë në \_\_\_\_\_ ?*

34. Kjo mohohet nga i Pandehuri **BK** (BK gjykimi, para. 449 dhe 450) por kundërshtohet nga rrëfimi i **FK** dhe **AK2** (FK gjykimi, para. 147 dhe 148; dhe **AK** gjykimi, para. 299-306). Trupi Gjykues konsideron se **BK** i ka parë viktimat. Dëshmia e **FK** është thashetheme e bazuar në atë çka i kishte thënë **IK** në biseda telefonike, por rrëfimi i **AK2** është rrëfim i qartë i dorës së parë. Gjykata konstatoi se **AK2** ishte përgjithësisht dëshmitar i besueshëm pasi që ai ka ofruar një rrëfim të qartë dhe të detajuar. Disa mospërputhje mund të shpjegohen nga tronditja dhe koha e shkurtër në të cilën kishte ndodhur prita disa nga të cilat diskutohen në vijim.

35. Më tej kjo tregon se pse **MK** kishte shkuar të konfrontohej me **IK** te lumi Llap me 6 Gusht 2011. Trupi Gjykues nuk i beson rrëfimit të **MK** për atë se si kishte ardhur të ia zë pritën **IK** (**MK** gjykimi, para. 271 deri 312). Koincidencat që **MK** kishte shkuar i armatosur te lumi Llap në kohën dhe vendin që koincidon me **IK** janë shumë të largëta. Trupi Gjykues beson se diçka e kishte nxitur reagimin e menjëhershëm të **MK** dhe konsideron se kjo ishte informata e pasuar nga djali i tij

**BK** se **IK** ishte kthyer. Mungesa e kontaktit të drejtpërdrejtë telefonik ndërmjet **BK** dhe babait të tij dhe prezenca e **BK** në shtëpinë e babait të tij (shiko në vijim) sugjeron fuqishëm se kjo informatë ishte pasuar personalisht.

36. Motivi i kuptueshëm i **MK** për të gënjer për përfshirjen e dy djemve të tij në vepër minon besueshmërinë e rrëfimit të tij në këtë aspEK.

*A ishte **BK** në Vushtrri në kohën e veprave?*

37. Trupi Gjykues nuk e gjen Alibinë e **BK** të jetë e besueshme. Alibia e **BK** bazohet në atë se ai kishte udhëtuar në Vushtrri për ta tërhequr pagesën e sigurimit social (Intervista e të Pandehurit **BK** e datës 6 Shtator 2011 (**BK** i pandehur), faqe 2 dhe 3; dhe **BK** gjykimi, para. 513 deri 544 dhe 564 deri 602). Rrëfimi i tij është bishtnues dhe i pavërtetuar. Trupi Gjykues nuk pranon se ai kishte kaluar periudhën përkatëse kohore në Vushtrri. Ai nuk mund të besojë se kishte kaluar një kohë të madhe në Vushtrri duke kryer një veprimtari të rregullt dhe duke u shoqëruar pa vërtetimin e një pale të tretë. Dëshmitarët e vetë **BK** të cilët i kishte thirrur për ta mbështetur alibinë e tij nuk arritën të konfirmojnë rrëfimin e tij (**AvK** gjykimi, para. 82 deri 93; dhe dëshmia e **BA** gjatë gjykimit e datës 15 Janar 2013, para. 56).

38. Trupi Gjykues i kushton pak rëndësi faktit që dy llogari telefonike të shfrytëzuara nga **BK** janë mbushur gjatë kësaj kohe në Vushtrri. Këto llogari mund të mbushen nga palë të treta pasi që prezenca e pronarit të telefonit nuk kërkohet.

39. Kundër kësaj Trupi Gjykues vendos rrëfimin e qartë të **AK3** i cili e vendos **BK** në (**AvK** gjykimi, para. 93) dhe rrëfimet e **AK2** dhe Bashkë-të pandehurit **EK** të cilët kombinojnë vendosjen e tij në para të shtënave, në shtëpinë e babait të tij, i cili ishte transportuar për në vendngjarje dhe në vendngjarje (**EK** i dyshuar, faqe 2; **EK** i pandehur, faqe 2; dhe **AK** gjykimi, para. 374 dhe 384).

40. Trupi Gjykues e konsideron dëshminë e procedurës paraprake të **EK** si të besueshme në këto pika. Asnjë justifikim i arsyeshëm nuk mund të vërtetohet se pse ai e inkriminon vetën apo me qëllim të keq inkriminon vëllain e tij deri në atë masë me gjithë raportin e dobët mes tyre.

*A kishte plan për t'i vrarë **IK**, **AK** dhe **AK2**?*

41. Trupi Gjykues vë në dukje dëshminë e **EK** i cili ka deklaruar se **BK** me **MK** shpesh bisedonin për hakmarrje (**EK** i dyshuar, faqe.4). Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje pohimin e **FK**

se **MK** dhe **BK** ishin parë nga fëmijët e saj dhe eventualisht nga ajo, duke ngarë veturën në afërsi të shtëpisë së tyre të re para vrasjeve (**FK** gjykimi, para. 128 deri 142).

42. Kishte armiqësi ndërmjet dy familjeve lidhur me vdekjen e **GK**. Në këso rrethanash Trupi Gjykses nuk e konsideron të pazakonshme që emocionet do të ngriteshin dhe hakmarrja do të diskutohej. Megjithatë, biseda për hakmarrje në vetvete nuk tregon qëllimin për të vrarë apo nuk tregon dëshmi për planifikim të paramenduar. **EK** nuk ka dëshmuar se babai dhe vëllai i tij kishin ndërmarrë ndonjë hap për ta vrarë **IK** para datës 6 Gusht 2011. Identifikimi i **FK** është i dobët dhe dëshmia e saj kryesisht mbështetet në thashetheme. Gjykata i kushton pak rëndësi kësaj dhe e konsideron se rëndësia e kësaj për vrasjet te lumi Llap- larg nga shtëpia e re- është e kufizuar.

43. Asnjë provë nuk sugjeron ndonjë periudhë të zgjatur të planifikimit dhe të shënjestrës specifike të te tri viktimave. Përkundrazi, Trupi Gjykses konsideron se plani ka qenë reagim spontan i nxitur nga paraqitja e **IK**. Nuk ka prova se janë monitoruar lëvizjet e **IK** nga ndonjëri i Akuzuar si përgatitje për pritë.

44. Trupi Gjykses nuk e konsideron të vërtetuar faktin se **BK** ka pasur qëllim apo ka ditur për ndonjë plan për ta vrarë **IK** apo fëmijët e tij kur e kishte pasur informatën te **MK**. Gjithashtu nuk është vërtetuar se prezenca e **AK** dhe **AK2** ishte zbuluar nga **BK** te **MK** deri sa ishte në shtëpinë e **MK**.

45. Trupi Gjykses e konsideron të vërtetuar faktin se **BK** dinte për një plan për ta vrarë **IK** para se të udhëtonin për në vendin e ngjarjes. Prezenca e vazhduar e **BK** te dhe nga shtëpia e **MK**s deri në vendngjarje dhe përgatitjet që i kishte bërë **MK** për të pasur qasje dhe për të përgatitur armën e vrasjes; të gjitha sugjerojnë një shkallë të dijenisë dhe të marrëveshjes apo pranimi të heshtur nga ana e **BK**.

46. Ekzistojnë prova të pamjaftueshme për të vërtetuar se **EK** ishte në dijeni për planin apo qëllimin e vrasjes së **IK** para se të arrinte në shtëpinë e **MK**. Gjithashtu nuk kishte prova të mjaftueshme për të sugjeruar se ai ishte në dijeni për prezencën e **AK** dhe **AK2**. Në rastin e fëmijëve Trupi Gjykses pranon se ai kishte intervenuar për ta ndalur babain e tij nga të shtënat pasi ishte qëlluar dhe ishte vrarë **IK** (**EK** i dyshuar, faqe.3; dhe **EK** i pandehur, faqe 3). Në kuptim të asaj që dinte para se ta dërgonte me veturë babain dhe vëllain e tij, ai pohon se nuk e kishte parë babain e tij me armën e vrasjes, babai i tij nuk kishte folur dhe **BK** kishte refuzuar të sqaronte se çka po ndodhte (**EK** i pandehur faqe 2).

47. Rrëfimi i **MK** motivohet për ta mbrojtur djalin e tij dhe për ta fshehur përfshirjen e tij. **MK** pohon se i kishte thënë djalit të tij se kishte nevojë të dërgohej te mjeku dhe djali i tij e kishte lënë atë në rrugë afër lumit Llap dhe ishte larguar (**MK** gjykimi para. 202). Ky rrëfim nuk konsiderohet i besueshëm, është jo logjike të pranohet se **EK** do ta dërgonte babain e tij deri në

skaj të rrugës larg nga mjeku menjëherë pasi **MK** kishte thënë se ndihej i sëmurë, në vend se ta çonte atë drejt te mjeku.

48. Trupi Gjykses e konsideron si tepër të pa gjasë që **EK** të mos i kishin treguar për planin e zënies së pritës së **IK** para se të arrinte me veturë në vendngjarje. Ki parasysh kontaktin telefonik ndërmjet **EK** dhe **BK**, historinë e armiqësisë ndërmjet dy vëllezërve dhe vështirësisë për fshehjen e armës me tytë të gjatë. Një qëllim i përbashkët është dashur t'i bënte të dy vëllezërit të bashkëpunonin së bashku. Trupi Gjykses nuk e pranon si të besueshme mundësinë që **EK** do ta pranonte dhe do ta realizonte kërkesën e vëllait të tij pa arsye apo justifikim të mirë. Asnjë alternativë bindëse nuk është ofruar nga Mbrojtja për ta ngritur dyshimin e bazuar për skenarin e paraqitur nga Prokurori.

49. Nuk ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar ndonjë diskutim të mëparshëm për vrasjen e **AK** dhe **AK2** apo që kjo të ishte objekt i ndonjë marrëveshje apo pritjes në heshtje ndërmjet ndonjë apo të gjithë të Pandehurve. Nuk ka prova që sugjerojnë se kjo ishte marrë në konsideratë në çdo nivel. Për besimin e **EK** veprimet e tij për të marrë armën nga babai i tij sugjeron se nuk kishte plan të përbashkët për t'i vrarë fëmijët.

*A e kishte thirrur **BK EK** për ta rregulluar transportin?*

50. Të dhënat telefonike si provë tregojnë qartë një numër thirrjesh ndërmjet dy vëllezërve para të shtënave (raportet telefonike të PTK-së për nr. 044 586 821 (dalje) të datës 15 Gusht 2011, në ora 12.11, 12.18 dhe 13.44 më 6 Gusht 2011). **BK** konfirmon se e posedonte numrin telefonik 044 867 409 por e mohon se i kishte bërë këto thirrje (**BK** gjykimi, para. 475 deri 482). Dëshmia e **EK** verifikon se ishte thirrur në shtëpinë e babait të tij për ta ofruar transportin për **MK** dhe **BK** edhe pse e konteston se kjo ka qenë me komunikim të drejtpërdrejt me **BK** (**EK** i dyshuar, faqe 2; dhe **EK** i pandehur, faqe 2). Sipas **EK**, **BK** kishte pritur për te në shtëpinë e **MK** (**EK** i pandehur, faqe 2).

51. Trupi Gjykses vë në dukje se raporti mes **BK** dhe **EK** ishte i dobët (**BK** i pandehur, faqe 2). Komunikimi i rregullt dhe kontakti ndërmjet atyre dyve nuk ishte normal dhe niveli i kontaktit nuk është përsëritur në ditët paraprahe. Prezenca e **IK** dhe dëshirat e babait të tyre kanë bërë që vëllezërit t'i lënë anash dallimet e tyre.

52. Trupi Gjykses nuk e pranon pohimin e **BK** se ai nuk e kishte thirrur **EK**. Pa marrë parasysh se a e ka pranuar **EK** kërkesën drejtpërdrejt apo tërthorazi nga **BK**, qëllimi i tij që **EK** ta sigurojë së pakut transportin është i qartë.

*A kishte udhëtuar **BK** me veturën e **EK** deri në vendngjarje?*

53. **EK** është i qartë se vëllai i tij ishte udhëtar me **MK** në veturën të cilën e kishte ngarë **EK** deri në vendngjarje (**EK** i dyshuar, faqe 2 dhe **EK** i pandehur, faqe 2). **MK** konfirmon se **EK** i kishte dërguar me veturë në vendngjarje por e mohon se **BK** kishte qenë aty (**MK** gjykimi, para. 161 deri 202). **AK2** e vendos **BK** në vendngjarje siç u cek tanimë (**AK** gjykimi, faqe 374).

54. Duke pasur parasysh se Trupi Gjykses refuzon pohimin e **MK** se **BK** nuk ishte prezent si një shembull ku babai përpiket ta mbrojë djalin e tij nga përgjegjësia penale. Komunikimi ndërmjet **EK** dhe **BK**, dëshmia e **EK** lidhur me prezencën e **BK** në shtëpi, qëllimi i **BK** për të qenë në shtëpinë e **MK**, prezenca e **BK** në vendngjarje dhe mungesa e transportit alternativ për **BK** të gjitha çojnë në atë se **BK** kishte udhëzuar me babain dhe vëllain e tij.

*A e kanë ditur **BK** dhe **EK** se **MK** ishte i armatosur?*

55. **EK** ka dëshmuar se nuk e ka ditur që **MK** ishte i armatosur kur kishte hyrë në veturë dhe këtë e kishte zbuluar më vonë në vendngjarje (**EK** i dyshuar, faqe 2 dhe **EK** i pandehur faqe 2). **MK** pohon se e kishte fshehur armën nën mantel gjatë një dite vere (**MK** gjykimi para. 185 deri 192). Rrëfimi i **EK** bie në kundërshtim. Kur është intervistuar më 7 Gusht 2011 ai kishte deklaruar qartë se babai i tij kishte veshur një “ xhakëtë të shkurtër [lëkure]” (**EK** i dyshuar, faqe 2). Ndërsa më 2 Shtator 2011 ai vërteton rrëfimin e **MK** se kishte të veshur një “xhakëtë të gjatë ngjyrë të kaltër [sic]” të cilën **MK** e vesh zakonisht gjatë dimrit (**EK** i pandehur, faqe 2).

56. **EK** dëshmon se babai i tij ishte ulur prapa në veturë, dhe **BK** ishte ulur në anën e shoferit (**EK** i dyshuar, faqe 2). Trupi Gjykses konsideron se arma do të kishte qenë shumë e vështirë për t’u fshehur. **BK** ishte me babain e tij kur po përgatiteshin me u nis dhe ishte ulur prapa në veturë me të. Pa marrë parasysh nëse babai i tij i kishte diskutuar shprehimisht qëllimet e tij, Trupi Gjykses konsideron se **BK** e dinte se babai i tij ishte i armatosur dhe e dinte qëllimit pas kësaj.

57. Është e besueshme që arma mund të fshihet nga shoferi. Megjithatë, duke pasur parasysh raportin familjar, gjasat për ta parë armën dhe rrethanat ku **EK** kishte siguruar transportin; Trupi Gjykses konsideron se është vërtetuar se ai e dinte që **MK** ishte i armatosur dhe qëllimin pas kësaj. **EK** pohon se e kishte ditur qëllimin për ta vrarë **IK** vetëm pasi grupi kishte arritur te lumi Llap (**EK** i dyshuar, faqe 4). Trupi Gjykses refuzon këtë pjesë të dëshmisë për arsyet e lartcekura.

58. Trupi Gjykues nuk vendos që **MK** kishte veshur mantel të gjatë në ditën në fjalë për ta fshehur armën. Me që vendi i ngjarjes ishte vend publik më shumë ka gjasa që ai të ketë veshur pallto për ta fshehur armën nga palët e treta dhe jo nga djemtë e tij. Gjersa ishte ulur në veturë manteli i gjatë nuk do t'i kishte ndihmuar **MK** për ta fshehur atë nga ata me të cilët ishte duke udhëtuar pasi që arma ishte tepër e gjatë.

*A e kishin shoqëruar **BK** dhe **EK** **MK** deri në pritë?*

59. Pohimi i **MK** se **BK** nuk ishte prezent dhe se **EK** ishte larguar me veturë pasi e kishte zbritur atë afër lumit Llap konsiderohet të jetë gënjeshtër për t'i mbrojtur djemtë e tij (**MK** gjykimi, para. 167, 168 dhe 202). **EK** e vendos vëllain e tij në vendngjarje dhe duke e shoqëruar **MK** nga vetura (**EK** i dyshuar, faqe 2; dhe **EK** i pandehur, faqe 2 dhe 3). Përveç kësaj ai pranon atë që pason me pastaj (Po aty). Dëshmia e **AK2** i vendos që të tre të pandehurit në vendngjarje në kohën e të shtënave (**AK** gjykimi, para.374). Trupi Gjykues vë në dukje se versioni i tij i ngjarjeve ka ndryshuar që nga intervista e parë e tij dhënë policisë (Intervista e dëshmitarit **AK2** e datës 6 Gusht 2011 (**AK** dëshmitar), faqe 2). Megjithatë, dëshmia e tij vërteton versionin e **EK** për ngjarjet më të rëndësishme deri në një shkallë shumë të konsiderueshme.

60. Trupi Gjykues vë në dukje se **EK** pranon se e kishte parë babain e tij që e kishte nxjerr armën e vrasjes dhe kishte filluar të hap zjarr (**EK** i dyshuar, faqe 2; dhe **EK** i pandehur, faqe 2). Megjithatë ai nuk e konfirmon se **BK** ishte aty në atë kohë. Trupi Gjykues ka marrë parasysh llojin e armës, shkallën e të shtënave, zjarrin e dukshëm pa dallim, mungesën e paralajmërimit dhe numrin e të shtënave. Afati kohor i sulmit ishte i kufizuar. Trupi Gjykues e konsideron të vërtetuar faktin që **EK** ishte atje apo në afërsi kur kishte filluar prita. Trupi Gjykues e konsideron të vërtetuar faktin se **BK** e kishte shoqëruar babain e tij deri në vendin e pritës dhe kjo ishte në afërsi. Edhe pse nuk është vërtetuar se ai ishte pranë **MK** kur kishte filluar prita.

61. Trupi Gjykues konsideron se me shoqërimin e babait të tyre **BK** dhe **EK** kanë treguar një shkallë të mbështetjes dhe njohurisë. Në fund të fundit edhe pse Trupi Gjykues është i bindur se vëllezërit kishin njohuri të nevojshme para se secili pret tyre të jepte kontributin në kryerjen e veprës. Shoqërimi i babait të tyre në pritë shton provat që Trupi Gjykues mund të konkludojë se përgjegjësia e mundshme penale rrjedh nga njohuria, por prezenca nuk është tregues kyç i njohurisë.



62. Në gjykim është përfshirë një vizatim nga Prokuroria autori dhe origjina e të cilit është e panjohur. **AK2** mohon se ka njohuri për vizatimin apo se kush e kishte bërë atë. Trupi Gjykes nuk i jep rëndësi kësaj prove. Në vend të kësaj, si pjesë e dëshmisë së tij në gjykim **AK2** ka paraqitur një vizatim i cili tregon tre sulmuesit.

*Kush ishte i armatosur?*

63. Është vërtetuar se **MK** ishte i armatosur me një armë automatike me tytë të gjatë (pushkë automatike Crvena Zastava, nr. serik 0-81383) gjatë pritës. Testet e mbetjes së barotit tregojnë vetëm se **MK** kishte shtënë me armë zjarri kohët e fundit (Raporti i Qendrës Shkencore të Forensikës, Kroaci i datës 8 Mars 2012). **BK** kishte dal negativ në testim për gjuajtje me armë. Vetëm gëzhojat nga arma e **MK** janë gjetur në vendngjarje (Raporti nga ekzaminimi i vendngjarjes i datës 6 Gusht 2011; Lista e provave e datës 6 Gusht 2011 dhe Kallëzimi Penal i datës 7 Gusht 2011) dhe nuk është gjetur ndonjë armë e dytë apo e tretë.

64. Trupi Gjykes konsideron se rrëfimi i **AK2** se ata të tretë ishin të armatosur është i pasAKë por kjo nuk e minon besueshmërinë e tij si dëshmitar. Trupi Gjykes pranon se prita ishte një ngjarje relativisht e shkurtër dhe intensive në të cilën ishin vrrarë babai dhe motra e tij dhe i ishte kërcënuar edhe jeta e tij. Rrëfimi i **AK2** sa i përket këtij fakti ishte i gabuar dhe nuk vërtetohet nga prova tjera.

*A e kishte ditur **MK** se ishin të pranishëm fëmijët?*

65. **MK** pohon se nuk i kishte parë fëmijët (**MK** gjykimi, para 354 dhe 355).

66. Trupi Gjykes konsideron se ai ishte dashur ta dinte se fëmijët ishin me babain e tyre para se të fillonte të qëllonte me armë. Dita e 6 Gushtit ishte një ditë e kthjelltë dhe me diell e verës dhe prita kishte ndodhur në një segment të drejtë rruge e cila kufizohet me sipërfaqe me vegetacion me lartësi të ulët deri të mesme (shiko Fotoalbumin e datës 6 Gusht 2011, fotografitë 1 deri 3, 6, 27, 47 dhe 102). Pamja e tij do të duhej të ishte e shkëlqyeshme. Fëmijët ishin në rimorkion e hapur dhe ishin ulur në të dy anët e babait të tyre (shiko Fotoalbumin e datës 6 Gusht 2011, fotografia 14; dhe **AK** gjykimi, para. 408 deri 412 dhe 436 deri 439). **MK** pranon se e kishte parë **IK** që po vinte dhe kishte hapur zjarr në një distancë të shkurtër jo më shumë se 5 metra (**MK** i pandehur, faqe 2; dhe **MK** gjykimi, para. 396 deri 397).

67. Fëmijët ishin ulur në një pozitë të dukshme dhe të ekspozuar dhe **MK** do të duhej të kishte vijë të qartë të pamjes nga një distancë relativisht e shkurtër. Trupi Gjykses konsideron si të pamundur që ai kishte mundur të shihte **IK** por jo fëmijët.

68. **MK** e kishte parë **AK2** por kishte vazhduar të shtënat dhe me qëllim kishte vënë në shënjestër atë. Trupi Gjykses ka marrë në konsideratë një numër faktorësh. Pozitën e **MK** duke lëvizur nga ana e majtë në të djathtë gjersa ishte me fytyrë kah **IK** ai ishte dashur ta shihte **AK2** në rimorkio dhe t'i ikte drejtimin kah vinte traktori; pozita e trupit të **IK** krahasuar me traktorin tregon se **MK** ishte dashur ta shihte atë duke rënë (dhe se objektivi i tij kryesor ishte kryer); dhe **AK2** ka dëshmuar se e kishte parë babain e tij duke rënë në tokë para se të ikte dhe ishte plagosur gjersa po ikte (Fotoalbumi i datës 6 Gusht 2011, fotografitë 13, 27 dhe 28; Skica e vendngjarjes dhe legjenda e skicës e datës 6 Gusht 2011; **MK** gjykimi, para. 402 deri 413; **AK** gjykimi, para. 374 dhe 445 deri 449). **EK** deklaroi se ai kishte intervenuar vetëm për shkak se **MK** kishte vënë në shënjestër **AK2**, duke rimbushur armën për ta bërë atë (**EK** i dyshuar, faqe 3). Dhe dëshmia e **MA** tregon se të shtënat akoma po vazhdonin në drejtim të **AK2** kur ai kishte arritur te shtëpia e saj (Deklarata e dëshmitares **MA** e datës 8 gusht 2011, faqe 2).

69. Për arsyet e lartcekura Trupi Gjykses konsideron të vërtetuar faktin se **MK** i kishte parë fëmijët me babain e tyre para se të hapte zjarr dhe para se të vazhdonte ta kishte në shënjestër **AK2** gjersa ai po ikte.

*A ishte **EK** në posedim apo kontroll të armës së vrasjes?*

70. **MK** pohon se **EK** nuk kishte qenë me të dhe se ai nuk e din çka kishte ndodhur me armën e vrasjes dhe municionin pas të shtënave (**MK** gjykimi, para. 212, 257 dhe 258). Trupi Gjykses gjënë pak besueshmëri në këtë rrëfim dhe e konsideron atë si një shembull tjetër të **MK** në përpjekje për ta mbrojtur djalin e tij.

71. Trupi Gjykses i beson rrëfimit të **EK** për marrjen e armës dhe municionit nga babai i tij gjatë të shtënave dhe fshehja e armës (Lista e gjësendeve të sekuestruara nga **EK** e datës 7 Gusht 2011). Bashkëpunimi i tij i plotë me policinë që nga fillimi dhe dorëzimi i armës së vrasjes sugjerojnë se ai nuk kishte motiv të gënjejë për posedimin e armës. Nuk ka prova se ai kishte njohuri që fëmijët ishin prezent apo që ai kishte dashur që fëmijët të vriten apo se e kishte pranuar këtë fakt.

## **8. LIGJI**

72. Trupi Gjykses nuk detyrohet me dispozitat e përcaktuara nga Prokuroria (Neni 386(2) i KPPK). Përveç kësaj sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) ekziston prezumimi se dispozita që është në fuqi në kohën e veprës vazhdon të zbatohet përveç nëse dispozita e re është më e favorshme për të Pandehurin (Neni 3(1) dhe (2)). Trupi Gjykses e ka interpretuar këtë si shikim primar në elementet qenësore të veprës por gjithashtu edhe nivelin dhe llogaritjen e ndonjë dënimi që lidhet me të.

73. Trupi Gjykses erdhi në përfundim se dispozitat e KPK për veprat e vrasjes duhet të zbatohen akoma pasi që KPRK nuk ishte më i favorshëm. Elementet relevante të veprës mbasin të njëjta qoftë sipas KPRK ose sipas KPK. I vetmi dallim është heqja e karakteristikës rënduese “mizorisht dhe dhunshëm” nga Neni 147(5) i KPK e cila konsiderohet e parëndësishme për arsyet e cekura më poshtë. Megjithatë, në raport me veprën e armëve të zjarrit kundër **MK** dhe **EK** elementet qenësore të veprës ishin të njëjta por dënimi dhe dispozitat ndëshkuese sipas KPRK ishin më të favorshme. Për veprën e armëve të zjarrit duhet të zbatohet KPRK.

### **8.1. Përgjegjësia penale**

74. Neni 11(1) i KPK ose Neni 17(1) i KPRK përcaktojnë qartë se personi është penalisht përgjegjës vetëm kur është mendërisht i aftë dhe kryen një vepër penale “me dashje apo nga pakujdesia.”

75. Për bashkë-kryerës përgjegjësia e tyre penale dhe dënimi kufizohen në kuadër të shkallës së dashjes së tyre (Neni 27(1) i KPK dhe Neni 36(1) i KPRK).

### **8.2. Vrasja**

76. Neni 146 i KPK e përkufizon vrasjen si:

“Kushdo që privon nga jeta një person tjetër...”

77. Elementi mendor i kësaj vepre kërkon dashjen siç specifikohet në Nenin 15 të KPK. Trupi Gjykses konsideron se pakujdesia nga Neni 16 është e kufizuar si element mendor i vrasjes nga pakujdesia nga Neni 149 i KPK.

### **8.3. Vrasja e rëndë**

78. Vrasja dhe vrasja e rëndë duhet të konsiderohen në raport me normën themelore dhe kualifikuese. Kjo e fundit është formë e rëndë dhe jo vepër e posaçme, siç shihet nga referimi i Nenit 147 për personin që është vrasës (i cili e ka privuar në rrethana të caktuara një person tjetër nga jeta). Si e tillë, lidhur me Nenin 146, vrasja e rëndë është kryer nëse një faktor rëndues nga Neni 147 është i pranishëm në vepër.

79. Kjo mund ta marrë formën e elementit mendor apo të një pozite plotësisht faktike. Në këtë rast Trupi Gjykes ka marrë në konsideratë paragrafët 1, 5 dhe 11:

“(1) privon nga jeta fëmijën;

...

(5) Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm;

...

(11) me dashje kryen dy apo më shumë vrasje... [përveç atyre të kryera në gjendje të afektit mendor apo vrasje të foshnjës gjatë lindjes].”

80. “Fëmija” përkufizohet si i moshës nën 18 vjeç (Neni 107(21) i KPK).

81. Karakteristika rënduese “mizorisht dhe dhunshëm” duhet të dallohet nga vrasja sipas Nenit 146 të KPK. Rrethanat e rastit duhet të tregojnë një shkallë të mizorisë kombinuar me shkallën e dhunës. Duke vepruar në mënyrë mizore dhe të dhunshme kryerësi përdor një metodë për ta shkaktuar vdekjen që shkon larg përtej, në mënyrë substanciale, të masës së nevojshme për shkaktimin e vdekjes.

82. Trupi Gjykes konsideron se elementi Aktiv dhe mendor i veprës rrjedh nga Nenet 15 dhe 146. Neni 147 është ndihmës dhe angazhohet kur është e pranishme një karakteristikë rënduese dhe kur dashja e kryerësit, në anën njohëse, mbulon të gjitha elementet e veprës, përfshirë edhe kriteret që rrisin dënimin. Për këtë arsye, në marrjen parasysh të përgjegjësisë për bashkë-kryerje ka mundësi të atribuohet një karakteristikë rënduese për qëllime të dënimit për një bashkë-kryerës në rastin e vrasjes derisa akoma mbahet bashkë-kryerja dhe vrasja nga Neni 146 (shiko diskutimin në vijim tek përgjegjësia e bashkë-kryerësve).

#### **8.4. Dashja e nevojshme për vrasje**

83. Vetëm Neni 15 i KPK duhet të merret në konsideratë në raport me vrasjen nga Nenet 146 dhe 147. Neni 16 i KPK duhet të përdoret vetëm për përcaktuar nëse vrasja nga pakujdesia ka ndodhur nga Neni 149 i KPK.

84. Neni 15 e përkufizon dashjen kur është prezentë ose drejtpërdrejt ose tërthorazi (“dashja eventuale”):

(2) Personi vepron me dashje të drejtpërdrejt kur... i vetëdijshëm për veprimin e [tij]... vepron dhe e dëshiron kryerjen e saj.

(3) Personi vepron me dashje eventuale kur... i vetëdijshëm se mund të ndodhë një pasojë e ndaluar si rezultat i veprimit të [tyre]... apo mosveprimit dhe ai... miraton ndodhjen e tij.”

85. Ligji kërkon që dashja si formë e *mens rea* para se të mund të vërtetohet përgjegjësia penale , me që pakujdesia është përjashtim (Neni 11 (3) i KPK).

86. Trupi Gjykes konsideron se përkufizimi i dashjes direkte është i qartë: personi duhet të dijë se ai/ajo është duke bërë diçka dhe duke dashur të veprojë ashtu. Me fjalë tjera, autori duhet t'i dijë elementet e veprës (elementi njohës) dhe të ketë vullnet që të bëjë që kjo të kryhet (elementi i vullnetshëm).

87. Megjithatë, dashja eventuale bazohet në atë se pasoja “ mund” të ndodh: kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se veprimet e tij mund të çojnë në kryerjen e një vepre (elementi njohës) dhe megjithatë pranon apo e miraton atë (elementi i vullnetshëm).

88. Trupi Gjykes konsideron se niveli i rrezikut duhet të jetë në një nivel dukshëm më të lartë se sa që është aplikuar në rrethanat e “pakujdesisë së vetëdijshme” dhe “pakujdesisë së pavetëdijshme ” që përdor fjalë të njëjta (shiko Nenin 16(2) dhe (3) të KPK).

89. Standardi i rrezikut të parashikuar në mënyrë të arsyeshme apo i rrezikut shumë të mundshëm do të ishte tepër i ultë nëse aplikohet në Nenin 15(3) të KPK. Trupi Gjykes beson se kjo do ta sillte dashjen eventuale shumë afër apo në të njëjtën kategori me pakujdesinë. Rreziku i parashikuar mundësisht duhet të jetë së pakut i mundshëm por nuk mund të jetë aq i lartë sa siguria pasi që kjo do të ishte dashje indirekte. Kjo reflekton përkufizimet e dashjes direkte, indirekte dhe eventuale diskutuar në juridiksione tjera si dhe në tribunalet ndërkombëtare dhe ad hoc dhe në Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

90. Test është nëse i Pandehuri kishte njohuri për rrezikun dhe e kishte pranuar apo pranuar në heshtje atë.

### **8.5. Bashkë-kryerja në vrasje**

91. Bashkë-kryerja në KPK përkufizohet si:

“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.” (Neni 23)

92. Përkufizimi mbulon personat të cilët marrin pjesë në mënyrë Aktive në kryerjen e veprës. Kjo e mbulon situatën ku personat veprojnë si bashkë-aktor kryesor në kryerjen e veprës ose duke adoptuar rolet e njëjta apo rolet e ndryshme që përmbushin elementin Aktiv të veprës (actus reus).

93. Pjesa e dytë e përkufizimit mbulon personat të cilët kanë bërë veprime përgatitore apo mbështetëse të cilat nuk janë elemente aktive apo adoptim i elementeve aktive të veprës por janë kontribute thelbësore që kanë ndikim në ekzekutimin e planit të përbashkët.

94. Në të dyja rastet personat duhet të veprojnë me një qëllim të përbashkët dhe me synim në kokë. Ata duhet të gjithë të kenë dashjen e nevojshme për ta kryer veprën që po kryej. Megjithatë, kjo nuk shtrihet në atë që të gjithë ata ndajnë shkallë të njëjtë të dashjes (për shembull të dashje direkte apo eventuale). Ky element i përbashkët mendohet për ta kryer veprën dallon bashkë-kryerësit nga ata që kryesisht ndihmojnë një palë të tretë por dashja e të cilëve është e kufizuar në dhënien e ndihmës dhe jo në kryerjen e veprës.

95. Në rastet e vrasjes Trupi Gjykes konsideron se kryerësit e veprës mund të jenë fajtor në shkallë të ndryshme të vrasjes nga veprimet e njëjta kriminale. Deri në një shkallë ku karakteristikat rënduese mund të vlejnë për një kryerës por jo për të gjithë. Kjo merr në konsideratë kufizimet në përgjegjësinë penale të përcaktuara me ligj. Bashkë-kryerja mund të ruhet edhe nëse kryerësit janë dënuar për vepra të ndryshme për aq sa elementet thelbësore të veprës janë të përbashkëta. Për shembull, elementet thelbësore të vrasjes nga Neni 146 janë të përbashkëta me vrasjen e rëndë nga Neni 147. Faktorët rëndues shtesë ndikojnë vetëm në dënimin e shqiptuar nga Neni 147. Kjo mundëson nivele të ndryshme të përgjegjësisë penale të nxirren nga veprimet e njëjta dhe lejon që bashkë-kryerësit të dënohen për vepra të ndryshme të cilat kanë elemente të përbashkëta aktive dhe mendore.

96. Në raste të tilla insistimi që të aplikohet niveli i njëjtë i veprës për të gjithë bashkë-kryerësit mund të ketë efekt të padëshirueshëm që: të kufizohet përgjegjësia penale e një kryerësi, përkundër veprimeve të tyre, duke shkuar përtej përgjegjësisë minimale me dashje të grupit (d.m.th. dënimet mund të jenë vetëm emëruesin më të ultë të dashjes penale); apo të rritet përgjegjësia e grupit që të jetë emëruesi më i lartë i përgjegjësisë (d.m.th. Të gjitha dënimet të emëruesi më i lartë) që mund të veprojë për shqiptimin e dashjes në një bashkë-kryerës ku ai apo ajo ka dashje të mjaftueshme për përgjegjësi më të madhe; apo të parandalohet dënimi për bashkë-kryerje ku veprimi i parashikuar nuk përputhet saktësisht me veprimet e rezultuara.

97. Trupi Gjykes do të theksojë se kjo është situatë e ndryshme ku akuza për ndihmë apo vepër tjetër të pazhvilluar; apo për vepër me karakter të ndryshëm do të ishte më e përshtatshme. Kjo gjithashtu nuk e mbulon rastin ku niveli i kërkuar i dashjes nuk shfaqet nga të gjithë bashkë-kryerësit.

## **8.6. Tentativa**

98. Neni 20(1) i KPK e përkufizon atë si:

“Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ...”

99. Tentativë do të thotë mungesë e kryerjes së plotë të veprës.

100. Është e qartë se elementet e veprës së referuar janë elementet aktive të veprës dhe jo elementet mendore. Mens rea që kërkohet për veprën e plotë duhet gjithmonë të plotësohet në mënyrë që të kemi tentativë: në anën njohëse, dashja e personit duhet t’i mbulojë të gjitha elementet e veprës, prapë duke përfshirë kriteret që rrisin dënimin; në anën e vullnetshme, personi duhet ta ketë shkallën e kërkuar të dashjes që kërkohet nga vepra në fjalë.

## **8.7. Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**

101. Kjo rregullohet me Nenin 374(1) të KPRK:

“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet ...”

102. Trupi Gjykses konsideron se kontrolli përfshin ruajtjen apo mundësinë e qasjes së armës, dhe posedimi përfshinë posedimin personal të armës njësojë sikur të kesh armën.

103. Pushka automatike Crvena Zastava (M70 AB2 nr. serik. 0-81383 dhe 72394) e kalibrit 7.62 x 39mm përkufizohet nga Neni 38(1) i KPRK si armë zjarri. Neni 38 gjithashtu e përkufizon municionin për armë zjarri si armë.

104. Përveç kësaj pushka dhe municioni janë armë të ndaluara nga Neni 4(1.1.2) dhe (1.1.4) i Ligjit për Armët (Ligji nr. 03/L-143) për të cilat nuk mund të merret leja nga personi fizik:

“ Armët e ndaluara të Kategorisë A – janë:

...

(1.1.2) Armët automatike të zjarrit (A2);

...

(1.1.4) Municioni me nivel të lartë depërtues, ...(A4)”

105. Armët automatike përkufizohen:

“...armë e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepet plumbi, dhe e cila mund të shkrepet me shumë se një plumb me një tërheqje të këmbëzës;” (Neni 2(1.10) i Ligjit për Armët)

Municioni me depërtim të lartë përkufizohet dhe në këtë rast përfshinë fishekët 7.76 x 39mm me bërthama metalike apo me mbështjellës të plotë metalik:

“...çdo... plumb pushke apo... municion me... bërthama të predhës prodhuar plotësisht (duke përjashtuar praninë e gjurmëve të substancave të tjera) nga legurat e tungstenit, çelikut, hekurit, bronzit, tunxhit, beriliumit, bakrit ... ose plumbat me mbështjellës të plotë më të mëdhenj se kalibri 5.6 mm prodhuar dhe paraparë për përdorim në pushkë, ku mbështjellësi i të cilëve peshon më shumë se 25% të peshës totale të predhës ...” (Neni 2(1.39) i Ligjit për Armët).

106. Përveç kësaj sipas Ligjit për Armët ekziston detyrimi për dorëzimit apo raportimit të çdo arme që i përket një anëtar të rritur të vdekur të familjes brenda afatit prej 30 ditësh nga vdekja; dhe detyrimi që menjëherë të raportohen në polici të gjitha armët dhe municioni i gjetur (Nenet 46 dhe 48 të Ligjit për Armët).

### **8.8. Elementi mendor lidhur me mbajtjen në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve**

107. Vetëm dashja mjafton për kryerjen e veprës pasi që pakujdesia nuk ofrohet shprehimisht sipas Nenit 374 të KPRK siç kërkohet me Nenin 17(2) të KPRK.

108. Dispozitat për dashjen janë të njëjta si në KPK ashtu edhe në KPRK përveç që referenca tani është Neni 21 i KPRK. Përkufizimet e dashjes direkte dhe eventuale janë të njëjta dhe për to u diskutua më lartë.

109. Dashje eventuale mund të jetë një AK mosveprimi por kjo vlen vetëm kur ekziston “...obligimi për të ndërmarrë një veprim por nuk arrin ta bëjë këtë.” (Neni 8(2) i KPRK). Trupi Gjykues konsideron se moskryerja e obligimit sipas Ligjit për Armët do të kualifikohet si mosveprim.

### **8.9. Mbrojtja e nevojshme**

110. Kjo përkufizohet me Nenin 12(2) të KPRK si:

“Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi..”

111. Një veprim i kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale (Neni 12(1) i KPK). Megjithatë, nëse veprimi është në shpërpjesëtim atëherë prapë do të aplikohet përgjegjësia penale por dënimi mund të zvogëlohet apo të lirohet nga dënimi në rrethana lehtësuese në raport me gjendjen mendore të personit (Neni 12(3) dhe (4) i KPRK)



112. Trupi Gjykses vë në dukje se kërcënimi mund t'i bëhet palës së tretë dhe kërcënimi duhet të jetë kumulativ për të qenë sulm i paligjshëm, real dhe i atëçastshëm.

### **9.Pika 1**

#### **Shtënia dhe vrasja e IK**

##### **A) MK**

113. I Pandehuri ka pranuar elementet Aktive dhe mendore të veprës. Faktet e vërtetuara tregojnë se ka dashur dhe ka dëshiruar t'ia zë pritën dhe ta vrasë **IK**. Duke vepruar bashkërisht me djemtë e tij **BK** dhe **EK**, ai kishte marrë armën në vendin e ngjarjes dhe ia kishte zënë pritën **IK**. Ai kishte shtënë me pushkë automatike pa paralajmërim duke e vënë në mënyrë specifike në shënjestër **IK**. Shkalla e zjarrit ishte ndalur dhe ai kishte rimbushur armën. Ai ka shtënë dhe ka vrasë **IK**.

114. **MK** ka vepruar me dashje direkte kur ka shtënë dhe ka privuar nga jeta **IK**. Kjo ishte rënduar duke e vrasë edhe **AK** në të njëjtën kohë (shiko në vijim).

115. Trupi Gjykses e hedh poshtë argumentin e Prokurorit që të aplikohet Neni 147(5) i KPK pasi që niveli i dhunës nuk është i mjaftueshëm. Vetëm shkalla e nevojshme e brutalitetit që mund të pritët nga përdorimi i një arme zjarri vdekjeprurëse ishte përdorur për ta shkaktuar vdekjen e **IK**.

116. Përgjegjësia e tij penale për bashkë-kryerje të vrasjes së rëndë nga Nenet 23 dhe 147 (11) të KPK të **IK** është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor sipas Neni 388(1) të KPRK.

##### **B) BK**

117. Edhe pse ai nuk ka marrë pjesë drejtpërdrejt në vepër **BK** ka vepruar në bashkë-kryerje me babain dhe vëllain e tij në vrasjen e **IK**.

118. Trupi Gjykses konsideron se ai ka vepruar me dashje direkte dhe ka ndarë qëllimin e përbashkët me **MK** dhe **EK**. Nga faktet e vërtetuara konsiderohet përtej dyshimit të arsyeshëm se ai e ka ditur dhe ka vepruar me babain e tij për t'ia zënë pritën dhe për ta vrasë **IK** kur ka kontaktuar me vëllain e tij për ta rregulluar transportin deri në vendngjarje. Ai ka vepruar me babain dhe vëllain e tij. Duke organizuar transportin deri në vendngjarje ai ka dhënë një kontribut thelbësor në kryerjen e veprës. Pa këtë vepra me gjasë nuk do të ndodhte. Transporti ishte i nevojshëm për të arritur te vendi i pritës, ka ofruar mjetin për ta fshehur armën nga pamja e publikut dhe mënyrën e ikjes nga vendngjarja.

119. Trupi Gjykses konsideron se ai nuk është fajtor për vrasjen e **AK** (shiko më poshtë) dhe kështu nuk ka dashjen e kërkuar për rëndimin e veprës nga Neni 147(11) i KPK.

120. Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Prokurorit për aplikimin e Nenit 147(5) të KPK pasi që niveli i dhunës nuk është i mjaftueshëm.

121. Përgjegjësia e tij penale për bashkë-kryerje të vrasjes nga Nenet 23 dhe 146 të KPK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor sipas Nenit 388(1) të KPPK.

### C) **EK**

122. Edhe pse ai nuk ka marrë pjesë drejtpërdrejt në vepër **EK** ka vepruar si bashkë-kryerës me babain dhe vëllain e tij në vrasjen e **IK**.

123. Trupi Gjykses konsideron se ai ka vepruar me dashje direkte dhe ka ndarë qëllimin e përbashkët bashkë me **MK** dhe **BK**. Nga faktet e vërtetuara konsiderohet përtej dyshimit të arsyeshëm se ai kishte dijeni për qëllimin e babait të tij për zënien e pritës dhe vrasjen e **IK** së pakut para se t'i transportonte vëllain dhe babain e tij nga shtëpia e **MK**. Ai e ka pranuar se kishte shumë gjasa që **IK** do të vritej nëse i zihet prita me armë automatike. Duke i dërguar ata me veturë ka dhënë kontribut qenësor në kryerjen e veprës. Pa këtë vepra me gjasë nuk do të ndodhte.

124. Trupi Gjykses konsideron se ai nuk është fajtor për vrasjen e **AK** (shiko më poshtë) dhe kështu nuk e ka dashjen e kërkuar për rëndimin e veprës nga Neni 147(11) i KPK.

125. Trupi Gjykses hedh poshtë argumentin e Prokurorit që të aplikohet Neni 147(5) i KPK pasi që niveli i dhunës nuk është i mjaftueshëm.

126. Përgjegjësia e tij penale për bashkëkryerje të vrasjes nga Nenet 23 dhe 146 të KPK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor sipas Nenit 388(1) të KPPK .

### Shtënia dhe vrasja e **AK**

#### A) **MK**

127. Përveç vrasjes së **IK**, Trupi Gjykses konsideron se i Akuzuari e kishte dashjen eventuale për të shtënë dhe vrarë **AK**. Ai nuk ka mundësi të mos e kishte parë **AK** me babain e saj gjersa po afroheshin. I Akuzuari duhej të kishte pamje të qartë dhe direkte të **IK** gjersa po afrohej. Ishte pasdite e hershme e një dite vere të kthjelltë. Ai ka mundur ta vlerësojë qartë afërsinë e ngushtë të fëmijëve nga babai i tyre. Prapëseprapë ai ka zgjedhur t'ia zë pritën **IK** pa kurrëfarë paralajmërimi dhe të hapë zjarr pa dallim me armë me shkallë të lartë të zjarrit kur kishte shumë gjasa që edhe **AK** mund të qëllohej dhe të vritej. Rezultati i veprimeve të tij ishte gjuajtja dhe vrasja e **AK**.

128. **MK** ka mundur ta shihte **AK** në rimorkio pasi që dukshmëria ishte e mirë dhe ai kishte pamje të qartë të traktorit dhe rimorkios gjersa po afroreshin. Ai është dashur ta ketë njohur atë sepse deri vonë ata kanë qenë fqinjë. Faktori rëndues nga Neni 147(1) i KPK është aplikuar pasi që **AK** ishte e moshës vjeçare dhe ishte fëmijë siç përkufizohet me ligj.

129. Trupi Gjykes konsideron se dashja e kërkuar mund të formohet mu para se të kryheshin elementet aktive të veprës dhe veprimi spontan është i mjaftueshëm. Në këtë rast **MK** ka formuar dashjen e nevojshme para se të fillonte të hapte zjarr.

130. Vrasja e **AK** qartë aplikon Nenin 147(1) të KPK si faktor rëndues. Ajo ishte e moshës vjeçare në kohën e vrasjes, gjë që **MK** ishte në dijeni për këtë.

131. Vrasja e babait të saj në të njëjtën kohë paraqet faktorin e dytë rëndues për vdekjen e së pakut dy personave në të njëjtën kohë (Neni 147(11) i KPK).

132. Edhe njëherë, Trupi Gjykes hedh poshtë argumentin e Prokurorit për aplikimin e Nenit 147(5) të KPK pasi që niveli i dhunës ishte i pamjaftueshëm.

133. Përgjegjësia e tij penale për veprën vrasje e rëndë nga Neni 147(1) dhe (11) të KPK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor në pajtim me Nenin 388(1) të KPPK.

#### B) **BK** dhe **EK**

134. Edhe pse **BK** ka qenë dashur ta shihte **AK** me babain e saj duke hyrë në fshatin nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai e kishte dashjen e kërkuar (direkte apo eventuale) për ta vrarë atë. Gjithashtu, nuk është vërtetuar se **EK** kishte dijeni për prezencën e **AK** para se ai t'i ketë transportuar babain dhe vëllain e tij dhe nuk ka prova që tregojnë dashjen e tij për ta vrarë atë.

135. Siç u cek më lart nuk është vërtetuar se **AK** ishte shënjestër e planifikuar dhe pranuar e pritës. Apo prezenca e është diskutuar dhe është marrë në konsideratë në ndonjë planifikim. Trupi Gjykes konsideron se rreziku i perceptuar nuk ishte mjaft i lartë për të përmbushur kërkesat nga Neni 15(3) i KPK. **BK** dhe **EK** u mungonte njohuria se me zënien e pritës së **IK**, kishte gjasa të mëdha që të qëllohej dhe vritej **AK**.

136. Përkundër kontributeve thelbësore të tyre për veprën asnjëri vëlla nuk e kishte dashjen e kërkuar direkte për shënjestrën e **AK**; apo kishin pranuar apo pranuar në heshtje nivelin e rrezikut të nevojshëm për përmbushjen e dashjes eventuale.

137. Gjithashtu, nuk janë mbledhur fakte për përmbushjen e pakujdesisë nga Neni 16 i KPK, të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Në të vërtetë, asnjë fakt i vërtetuar nuk tregon se ndonjëri nga vëllezërit e kishte paraparë ndonjëherë rrezikun që **AK** të bëhej dëm shtesë. Vrasja dhe plagosja e dy fëmijëve është vetëm rezultat i veprimeve të **MK**, përkatësisht të shtënat e tij

me armë pa dallim menjëherë pasi që kishte vërejtur traktorin. Asnjë rrethanë nuk ka zbuluar se vëllezërit kanë mundur të prisnin këtë rezultat.

138. Përgjegjësia penale e **BK** dhe **EK** për veprën e bashkë-kryerjes së vrasjes së rëndë nga Nenet 23 dhe 147(1) të KPK nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ata lirohen në pajtim me Nenin 390(3) të KPPK.

## **10. Pika 2**

### **Shtënia dhe plagosja e AK2**

#### **A) MK**

139. Trupi Gjykues konsideron se faktorët relevantë në raport me **AK** vlejné njësojë edhe për **AK2**. Është e qartë se **MK** kishte dashjen eventuale për ta vrarë **AK2** kur ka filluar të hap zjarr në **IK** dhe në grup. Kjo në vetvete është e mjaftueshme për ta përmbushur veprën.

140. Dashja e **MK** pastaj ka kaluar në dashje direkte gjersa ka vënë në shënjestër **AK2** gjersa **AK2** po ikte nga vendngjarja. Duke vazhduar ta ketë në shënjestër **AK2** ai ka treguar dëshirën për ta vrarë atë. Kishte qenë vetëm intervenimi i **EK** ai që i kishte ndaluar të shtënat.

141. Me hapjen e zjarrit **MK** kishte ndërmarrë hapat e menjëhershëm për kryerjen e veprës. Kanë qenë vetëm veprimet e **AK2**, fati dhe intervenimi eventual i **EK** që kishin parandaluar përfundimin e elementeve aktive të veprës.

142. **AK2** ishte vetëm 11 vjeçar në kohën e të shtënave, gjë që **MK** e dinte këtë.

143. Përgjegjësia penale e **MK** për vrasjen e rëndë në tentativë nga Nenet 20 dhe 147(1) të KPK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor sipas Nenit 388(1) të KPPK.

#### **B) BK dhe EK**

144. Edhe pse **BK** është dashur ta kishte parë **AK2** me babain e tij duke hyrë në fshatin Grace nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ai e kishte dashjen e kërkuar (direkte apo eventuale) për ta vrarë atë. Po ashtu nuk është vërtetuar se **EK** kishte njohuri për **AK2** dhe kështu kishte formuar dashjen e kërkuar.

145. Nuk është vërtetuar se **AK2** ishte shënjestër e planifikuar dhe e pranuar e pritës. Apo prezenca e **AK2** ishte diskutuar dhe marrë në konsideratë në planifikim. Trupi Gjykues konsideron se rreziku i perceptuar nuk ishte mjaft i lartë për të përmbushur kërkesat nga Neni 15(3) i KPK. **BK** dhe **EK** u mungonte njohuria se me zënien e pritës së **IK**t, kishte gjasa të mëdha që **AK2** mund të qëllohej dhe eventualisht të vritej.

146. Përkundër kontributit të tyre thelbësor në vepër asnjëri vëlla nuk kishte dashjen e kërkuar direkte për vënien në shënjestër të **AK2**; apo nuk kishin pranuar apo pranuar në heshtje deri në nivelin e kërkuar të rrezikut për ta përmbushur dashjen eventuale.

147. Trupi Gjykues vë në dukje intervenimin e **EK** për t'i ndaluar të shtënat pasi ishte qëlluar dhe vrarë **IK**. Pa këtë intervenim **AK2** mund të mos kishte mbijetuar.

148. Përgjegjësia penale e **BK** dhe **EK** për veprën vrasje e rëndë në bashkëkryerje nga Nenet 23 dhe 147(1) të KPK nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ata lirohen në përputhje me Nenin 390(3) të KPPK.

### 11. Pika 3

*Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve*

#### A) **MK**

149. **MK** e pranon posedimin dhe kontrollin e armës së vrasjes. Pushka automatike është armë siç përkufizohet me Nenin 38(120) të KPRK siç është edhe municioni. Ai nuk ka ndonjë leje për armë dhe në çdo rast këto ndalohen me Ligjin për Armët. Pushka automatike armë e ndaluar e kategorisë A2 dhe nëntë fishekët 7.62 x 39mm janë armë të ndaluara të kategorisë A4 pasi që ata qartë kanë mbështjellësa të plotë metalik (shiko Ligjin për Armët).

150. **MK** e kishte dashjen e kërkuar direkte. Ai mbante armën e djalit të tij dhe më 6 Gusht 2011 e kishte marrë atë me vete në vendngjarje.

151. Ato në fillim i takonin djalit të tij të ndjerë dhe ai e mbante pushkën automatike dhe municionin për disa vite. Ai kishte dështuar në dorëzimin e armëve autoriteteve përgjegjëse.

152. Përgjegjësia e tij penale për veprën mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga Neni 374(1) i KPRK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor në përputhje me Nenin 388(1) të KPPK.

#### B) **EK**

153. **EK** e pranon posedimin dhe kontrollin e armës së vrasjes. Pushka automatike është armë siç përkufizohet me Nenin 38(120) të KPRK siç është edhe municioni. Ai nuk ka ndonjë leje për armë dhe në çdo rast këto ndalohen me Ligjin për Armët. Pushka automatike armë e ndaluar e kategorisë A2 dhe nëntë fishekët 7.62 x 39mm janë armë të ndaluara të kategorisë A4 pasi që ata qartë kanë mbështjellësa të plotë metalik (shiko Ligjin për Armët).

154. **EK** e kishte dashjen e kërkuar direkte për kryerjen e veprës. Është e pranueshme që ai fillimisht ka vepruar në mbrojtje të nevojshme të **AK2** i cili ishte nën kërcënimin real dhe të vazhdueshëm nga **MK**. Po të ishte kufizuar posedimi i armës në ndaljen e atij kërcënimi ai nuk do të ballafaqohej me përgjegjësi penale p.sh duke pritur që rreziku të kalojë dhe lënia e armës në vendin e krimit. Megjithatë, ai ka vazhduar ta mbante armën në posedim dhe e ka pasur edhe më tej armën dhe municionin nën kontroll duke i fshehur ato. Ai nuk e kishte braktisur armën dhe nuk e kishte lajmëruar në polici. Mbështetja në mbrojtje të nevojshme kufizohet në kohën

deri sa ka ekziston kërcënimi. Në këtë rast dashja e tij për ta poseduar dhe kontrolluar armën e tejkalon këtë afat kohor. Nuk ekziston ndonjë kohë minimale para se të jetë formuar dashja e kërkuar. Veprimet e **EK** nuk sugjerojnë se dashja e tij e dytë ishte për t'ua dorëzuar armën autoriteteve. Kjo kishte ngjarë vetëm më vonë pas arrestimit të tij.

155. Ato fillimisht i takonin vëllait të tij të ndjerë. Ai e kishte marrë atë nga babai i tij **MK** pas të shtënave me qëllim të eliminimit të armës.

156. Përgjegjësia penale për veprën Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të armëve nga Neni 374(1) i KPRK është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Ai është fajtor në përputhje me Nenin 388(1) të KPPK.

## **12. DËNIMI**

### **12.1. Ligji**

157. Në mënyrë që të merret në konsideratë ligji më i favorshëm duhet të merren në konsideratë dhe të aplikohen sanksionet ndëshkuese, nivelet dhe regjimi i të dy kodeve i KPK dhe KPRK. Fillimisht, pjesët përkatëse të të dyja Kodeve janë paraqitur dhe diskutuar. Pastaj janë aplikuar të dy Kodet për secilën pikë ku i Pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën.

#### *Kodi Penal i Kosovës (KPK) (2003)*

158. Dënimi për vrasje të rëndë është së pakut 10 vjet burgim apo burgim afatgjatë që është nga 21 deri në 40 vjet burgim (Nenet 37(2) dhe 147 të KPK). Vrasja bartë dënimin minimal prej pesë vjet burgim dhe dënimin maksimal prej 20 vjet burgim për ta dalluar atë nga burgimi afatgjatë (Nenet 38(1) dhe 146 të KPK). Kur një kryerës ka vepruar në bashkë-kryerje dënimi do të jetë i shkallës së njëjtë si për veprën materiale, por dënimi duhet të reflektojë nivelin e dashjes së bashkë-kryerësit (Nenet 23 dhe 27(1) të KPK).

159. Sanksioni për kontrollin, posedimin apo pronësinë e paautorizuar të armës është ose dënimi me gjobë prej 50 euro deri në maksimum 7,500 euro ose dënimi me burg prej një deri në tetë vjet (Nenet 39(1) dhe 328(2) të KPK).

160. Kur një kryerës shpallet fajtor për një veprë në tentativë dënimi maksimal duhet të jetë i limituar në 75% të shkallës së dënimit (Nenet 20(3) dhe 65(2) të KPK).

161. Gjykata duhet të marrë në konsideratë: sanksionet sipas veprës, qëllimin e dënimit dhe rrethanat rënduese apo lehtësuese. Gjykata duhet t'i ketë parasysh shtatë faktorë që lidhen me rrethanat rënduese apo lehtësuese por nuk kufizohet vetëm në ta. Çdo dënim duhet të jetë proporcional me veprën. (Neni 65(1) i KPK).

162. KPK nuk kufizon shprehimisht se çka mund të konsiderohet faktor rëndues apo lehtësues.

163. KPK përcakton se si caktohet dënimi unik për veprat në bashkim (Neni 71 i KPK). Nëse caktohet dënimi me burg afatgjatë për një të njërit nga veprat do të ekzekutohet vetëm ky sanksion (Neni 71(1) i KPK). Nëse caktohet dënimi me burg dënimi unik duhet të jetë më i lartë se dënimi individual; por më i ultë se periudha e kombinuar kohore e çdo dënimi të veçantë dhe nuk tejkalon dënimin prej 20 vjet burgim (Neni 71(2) i KPK). Kur dënimet individuale të shqiptuara janë deri në tre vjet burgim dënimi unik maksimal nuk tejkalon dënimin prej tetë vjet burgim (Neni 71(3) i KPK). Nëse dënimi individual është gjorbë, gjoba unike nuk mund të tejkalojë shumën prej 25,000 euro; ose nëse së pakut një veprë është kryer për përfitim material gjoba unike nuk tejkalon shumën prej 50,000 euro (Neni 71(4) i KPK). Më në fund, kur sanksionet e shqiptuara janë kombinim i dënimit me burg dhe gjorbë do të zbatohen dispozitat pararendëse (Neni 71(5) i KPK).

164. Koha që kryerësi ka kaluar në paraburgim (paraburgim dhe arrest shtëpiak) duhet të merret gjithashtu në konsideratë dhe të llogaritet për periudhën e njëjtë (Neni 73 i KPK). Një ditë e paraburgimit është baras me 20 euro kur të kalkulohet gjoba (Neni 73(4) i KPK).

#### *Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK) (2012)*

165. Kohëzgjatja minimale e burgimit që aplikohet për vrasje dhe vrasje të rëndë është e njëjtë si në KPK – pesë përkatësisht 10 vjet (Nenet 178 dhe 179(1) i KPRK).

166. Për vrasje, kohëzgjatja maksimale e burgimit është rritur në 25 vjet (Neni 45(1) i KPRK). Po ashtu, një dënim i ri me “burgim të përjetshëm” ka zëvendësuar dënimin me burg afatgjatë. Sipas KPRK nuk ka periudhë maksimale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me burg të përjetshëm dhe periudha minimale është ngritur në 25 vjet për ta dalluar atë nga burgimi (Neni 45(1) i KPRK).

167. Për kontroll, posedim apo pronësi të paautorizuar të armës sanksionet janë të njëjta sikur edhe në KPK përveç gjobës minimale që është rritur në 100 euro dhe shkalla e dënimit me burg është ulur në 30 ditë deri në pesë vjet (Nenet 45, 46(1) dhe 374(2) të KPRK).

168. Për veprat në tentativë dënimi mund të zvogëlohet për të reflektuar rrethanat e mos përfundimit të veprës. Megjithatë, nuk ka kufi të detyruar të shkallës së dënimit sipas veprës materiale. Zvogëlimi prej 25% i shkallës së dënimit sipas KPK është hequr. (Neni 28(3) i KPRK).

169. Rregullat e përgjithshme për llogaritjen e dënimit janë të njëjta si në KPK (Neni 73(1) deri (3) i KPRK). Përveç kësaj KPRK përcakton shprehimisht rrethanat e pashterueshme renduese dhe lehtësuese të cilat do të merren në konsideratë (Neni 74(2) dhe (3) i KPRK). Ky është një ndryshim nga KPK dhe kodifikon disa nga faktorët më të zakonshëm.

170. KPRK kryesisht riprodhon dispozitat e KPK paraprak sipas Nenit 80 të KPRK për sanksionet e dënimit unik me disa ndryshime të vogla. Së pari, referenca për burgim afatgjatë është zëvendësuar me burgim të përjetshëm. Së dyti, dënimi unik për burgim është limituar deri në 25 vjet burgim (është ngritur nga 20 vjet sipas KPK). Së fundit, limiti për gjobë kur së pakut një vepër është për përfitim material tani është 500,000 euro (është ngritur nga 50,000 euro sipas KPK). (Neni 80(2)(2.1) deri (2)(2.5) i KPRK.)

171. Koha të cilën kryerësi e ka kaluar në paraburgim gjatë procedurës paraprake (paraburgim dhe arrest shtëpiak) duhet gjithashtu të merret në konsideratë dhe të llogaritet për periudhën e njëjtë (Neni 83 i KPRK). Një ditë në paraburgim është baras me 20 euro në llogaritjen e gjobës (Neni 83(4) i KPRK).

## **12.2. Pika 1**

### ***A) MK***

#### **Vrasja e IK**

172. Faktorët rëndues janë të qartë: hakmarrja për vdekjen e djalit të tij **GK**, roli i tij primar si nxitës i planit për ta vrarë **IK**, furnizues i armës dhe sulmues. Si rrethanë lehtësuese mosha e shtyrë e tij, rrethanat personale, mungesa e ndonjë dënimi paraprak, pranimi i vazhdueshëm i përgjegjësisë nga ai që nga arresti deri në shqyrtimin gjyqësor janë marrë në konsideratë.

173. Trupi Gjyqësor pranon se motivi i tij për ta vrarë **IK** ishte i bazuar në humbjen e djalit të tij. Megjithatë, Gjykata nuk mund t'i justifikojë veprimet e tij kur viktimja kishte qenë i liruar nga akuza nga gjykata.



#### *Zbatimi i KPK*

174. Shkalla e dënimit është 10 deri 20 vjet apo burgim afatgjatë siç u shpjegua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduar deri në atë shkallë apo që pasojat ishin aq të rënda për ta arsyetuar dënimin me burg afatgjatë.

175. Në këtë rast janë marrë në konsideratë mbrojtja publike dhe parandalimi si qëllime kryesore të dënimit. Rrethanat e mësipërme rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysht dhe konsiderohen në përputhje me Nenin 65 të KPK.

176. Për vdekjen e **IK** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 15 vjet burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

177. Shkalla e dënimit është 10 deri 25 vjet burgim apo burgim i përjetshëm siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në atë masë apo që rrethanat ishin aq të rënda për ta justifikuar burgimin e përjetshëm.

178. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysht dhe konsiderohen në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.1) deri (2.3), (2.6) dhe (2.8), (3.2) deri (3.3), (3.6), (3.10) dhe (3.11) të KPRK.

179. Për vrasjen e **IK** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 17 vjet burgim sipas KPRK.

#### *Përfundim*

180. KPRK nuk është më i favorshëm se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(1) të KPRK. **MK** dënohet me 15 vjet burgim në përputhje me Nenin 38(2) të KPK.

#### *Vrasja e AK*

181. Rrethanat rënduese dhe lehtësuese që zbatohen për vdekjen e **IK** vlejné edhe për vdekjen e **AK**. Përveç kësaj **MK** nuk ka treguar keqardhje për vdekjen e fëmijës dhe nuk ka

prova për planin e paramenduar për ta vrarë **AK**. Trupi Gjykses konsideron se indiferenca ndaj prezencës së **AK** e shfaqur nga **MK** dhe mungesa e motivit nënkupton që dënimi duhet të jetë më i lartë se sa ai që është aplikuar për vrasjen e **IK**.

#### *Zbatimi i KPK*

182. Shkalla e dënimit është 10 deri 20 vjet apo burgim afatgjatë siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduar deri në atë shkallë apo që pasojat ishin aq të rënda për ta arsyetuar dënimin me burg afatgjatë.

183. Në këtë rast janë marrë në konsideratë mbrojtja publike dhe parandalimi si qëllime kryesore të dënimit. Rrethanat e mësipërme rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenin 65 të KPK.

184. Për vdekjen e **AK** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 17 vjet burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

185. Dënimi është 10 deri 25 vjet burgim apo burgim i përjetshëm siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në atë masë apo që rrethanat ishin aq të rënda për ta justifikuar burgimin e përjetshëm.

186. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.1) (2.3), (2.6) deri (2.8), (3.3), (3.6), (3.10) dhe (3.11) të KPRK.

187. Për vdekjen e **AK** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 21 vjet burgim sipas KPRK.

#### *Përfundim*

188. KPRK nuk është më i favorshëm se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(1) të KPRK. **MK** dënohet me 17 vjet burgim në përputhje me Nenin 38(2) të KPK.

#### *B) BK*

### Vrasja e **IK**

189. **BK** dënohet për bashkë-kryerje në vrasjen e **IK**.

190. Trupi Gjykses konsideron se këta faktorë rëndues dhe lehtësues aplikohen për **BK**.

191. Faktorë rëndues janë motivimi për hakmarrje për vdekjen e **GK**, roli i tij qendror në lehtësimin e veprës dhe mënyra në të cilën është vrarë **IK**. **BK** konsiderohet të ketë pasur rol më aktiv se sa **EK**. Si lehtësim Trupi Gjykses pranon se **BK** nuk ka pasur dënime paraprake.

192. Trupi Gjykses merr në konsideratë shkallën e përgjegjësisë penale të **BK** si bashkë-kryerës. Pa përfshirjen e tij Trupi Gjykses konsideron se nuk do kishte gjasa që të kryhej vepra.

### *Zbatimi i CCK*

193. Shkalla e dënimit është 10 deri 20 vjet apo burgim afatgjatë siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduar deri në atë shkallë apo që pasojat ishin aq të rënda për ta arsyetuar dënimin me burg afatgjatë.

194. Në këtë rast janë marrë në konsideratë mbrojtja publike dhe parandalimi si qëllime kryesore të dënimit. Rrethanat e mësipërme rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenin 65 të KPK.

195. Për vdekjen e **IK** Trupi Gjykses do ta dënonte **BK** me 9 vjet burgim sipas KPK.

### *Zbatimi i KPRK*

196. Dënimi është 10 deri 25 vjet burgim apo burgim i përjetshëm siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në atë masë që rrethanat ishin aq të rënda për ta justifikuar burgimin e përjetshëm.

197. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.2) (2.3), (2.6), (2.8) dhe (3.3) të KPRK.

198. Për vdekjen e **IK** Trupi Gjykses do ta dënonte **BK** me 11 vjet burgim sipas KPRK.

### *Përfundim*

199. KPRK nuk është më i favorshëm se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(1) të KPRK. **BK** dënohet me 9 vjet burgim në përputhje me Nenin 38(2) të KPK.

### *C) EK*

#### Vrasja e IK

200. **EK** dënohet për bashkë-kryerje në vrasjen e **IK**.

201. Trupi Gjykes konsideron se këta faktorë rëndues dhe lehtësues aplikohen për **EK**.

202. Sjellja e **EK** rëndohet nga motivimi për hakmarrje, ai ka luajtur një rol kyç në transportimin e babait të tij në vendngjarje pa këtë transport vepra me gjasë nuk do të ndodhte. Moshë e **EK** merret si lehtësim për pjesën e tij të veprës si dhe keqardhja dhe bashkëpunimi i hershëm me policinë dhe prokurorin. Gjithashtu vihet në dukje se ai ka luajtur një rol më pak Aktiv se sa vëllai i tij, **BK**.

#### *Zbatimi i KPK*

203. Dënimi është 10 deri 20 vjet apo burgim afatgjatë siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykes nuk konsideron se rrethanat ishin rënduar deri në atë shkallë apo që pasojat ishin aq të rënda për ta arsyetuar dënimin me burg afatgjatë.

204. Në këtë rast janë marrë në konsideratë mbrojtja publike dhe parandalimi si qëllime kryesore të dënimit. Rrethanat e mësipërme rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenin 65 të KPK.

205. Për vdekjen e **IK** Trupi Gjykes do ta dënonte **EK** me 7 vjet burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

206. Dënimi është 10 deri 25 vjet burgim apo burgim i përjetshëm siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykes nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në atë masë që rrethanat ishin aq të rënda për ta justifikuar burgimin e përjetshëm.

207. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.3), (2.6), (2.8), (3.6), (3.8), (3.9) dhe (3.11) të KPRK.

208. Për vdekjen e **IK** Trupi Gjykses do ta dënonte **EK** me 9 vjet burgim sipas KPPK.

#### *Përfundim*

209. KPRK nuk është më i favorshëm se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(1) të KPRK. **BK** dënohet me 7 vjet burgim në përputhje me Nenin 38(2) të KPK.

### **12.3. Pika 2**

#### ***MK***

#### *Vrasja në tentativë e AK2*

210. Ai dënohet për vrasje në tentativë të **AK2**.

211. Trupi Gjykses konsideron se faktorët rëndues dhe lehtësues zbatohen për **MK**. Roli i tij primar si nxitës i planit për vrasjen e **IK**, furnizues i armës dhe sulmues nënkupton se ai ishte pjesëmarrësi kryesor në sulmin e **AK2**. **AK2** ishte i pambrojtur dhe i rrezikuar, dhe ka pësuar tronditje mendore që nga sulmi. Si lehtësim mosha e shtyrë, rrethanat personale, mungesa e dënimeve paraprake, keqardhja e tij në raport me **AK2** dhe pranimi i vazhdueshëm nga ana e tij e përgjegjësisë nga arresti deri në shqyrtimin gjyqësor janë marrë në konsideratë.

#### *Zbatimi i KPK*

212. Dënimi maksimal për tentativë është 75% i dënimit maksimal të paraparë me KPK – në këtë rast deri në 21 vjet por duke mos përfshirë 21 vjet për burgim dhe 40 vjet për dënim afatgjatë (Neni 65(2) i KPK). Trupi Gjykses konsideron se zvogëlimi bëhet në dënimin maksimal të paraparë dhe nuk aplikohet pasi të merren në konsideratë faktorët rëndues dhe lehtësues në një rast individual.

213. Duke pasur këtë parasysh, shkalla e dënimit për vrasje të rëndë në tentativë është nga 10 deri 15 vjet apo nga 21 deri në 30 vjet.

214. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në shkallën apo se pasojat ishin aq të rënda për të justifikuar burgimin afatgjatë.

215. Në këtë rast mbrojtja e publikut dhe parandalimi janë qëllimet kryesore të dënimit që merren në konsideratë. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsideruara në përputhje me Nenin 65 të KPK.

216. Për vrasjen e rëndë në tentativë të **AK2** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 12 vjet burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

217. Pasi kjo ishte një tentativë duhet të merret në konsideratë si e tillë. Megjithatë nuk ka zvogëlim të detyrueshëm të masës së dënimit maksimal nga 10 deri në 25 vjet apo të dënimit me burg të përjetshëm siç u specifikua më lartë. Përkundër natyrës së veprave Trupi Gjykses nuk konsideron se rrethanat ishin rënduese deri në shkallën apo se pasojat ishin aq të rënda për të justifikuar burgimin e përjetshëm.

218. Në anën tjetër, Trupi Gjykses nuk ka gjetur ndonjë arsye për ta zvogëluar dënimin sipas Neneve 28 (3) dhe 75 (1) 1.1 të KPRK.

219. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysh dhe konsiderohen në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.1), (2.3), (2.6), (2.8), (3.3), (3.6), (3.10) dhe (3.11) të KPRK.

220. Për vrasjen e rëndë në tentativë të **AK2** Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 15 vjet burgim sipas KPRK.

#### *Përfundim*

221. KPRK nuk është më i favorshëm se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(1) të KPRK. **MK** dënohet me 12 vjet burgim në përputhje me Nenin 38(2) të KPK.

### 12.4. Pika 3

#### A) **MK**

222. Ai dënohet për Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve.

223. Trupi Gjykses konsideron se rrethana rënduese janë këto: shkalla e lartë e pjesëmarrjes në veprë. Ai ka pasur dijeni për armët për disa vite dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje t'i dorëzojë ato tek autoritetet. Vepra më tutje rëndohet nga armët që kanë qenë të ndaluara. Mbajtja e vazhdueshme e armëve të ndaluara dhe pa autorizim vetëm ndihmon veprat e rënda penale shpesh me përfundim tragjik.

224. Si lehtësim Trupi Gjykses e konsideron moshën e tij dhe bashkëpunimin me policinë për përgjegjësinë e tij penale.

#### *Zbatimi i KPK*

225. Sanksionet me gjobë maksimale prej 7,500 euro apo dënimi prej një deri në tetë vjet burgim aplikohen në këtë rast (Neni 328(2) i KPK).

226. Në këtë rast parandalimi është qëllimi kryesor i dënimit që merret në konsideratë. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë në konsideratë në përputhje me Nenin 65 të KPK.

227. Për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 5 vjet e 6 muaj burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

228. Sanksionet me gjobë maksimale prej 7,500 euro apo dënimi me burg deri në pesë vjet aplikohen në këtë rast (Neni 374(1) i KPRK).

229. Rrethanat e lartcekura rënduese dhe lehtësuese janë marrë parasysht dhe në konsideratë në përputhje me Nenet 73 dhe 74(2.1), (2.2), (3.3), (3.6), dhe (3.10) të KPRK.

230. Për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve Trupi Gjykses do ta dënonte **MK** me 3 vjet burgim sipas KPRK.

#### *Përfundim*

231. KPRK është më i favorshëm se sa ligji që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPRK duhet të aplikohet në përputhje me Nenin 3(2) të KPRK. **MK** dënohet me 3 vjet burgim në përputhje me Nenin 45 të KPRK.

#### *B) EK*

232. Ai dënohet për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve.

233. Trupi Gjykses konsideron se për **EK** nuk aplikohet ndonjë masë rënduese për këtë veprë. Një numër rrethanash lehtësuese janë gjetur nga Trupi Gjykses ku përfshihet bashkëpunimi vullnetar i tij me hetimin policor duke dorëzuar armët, dhe periodha e shkurtër ku ai ka qenë në kontroll dhe posedim të armëve.

234. Si lehtësim Trupi Gjykses konsideron moshën e tij dhe bashkëpunimin me policinë lidhur me përgjegjësinë e tij penale.

#### *Zbatimi i KPK*

235. Sanksionet me gjobë maksimale prej 7,500 euro apo dënim me një deri në tetë vjet burgim aplikohen në këtë rast (Neni 328(2) i KPK).

236. Në këtë rast parandalimi është qëllimi kryesor i dënimit që merret në konsideratë. Rrethanat e lartcekura lehtësuese janë marrë parasysh dhe në konsideratë në përputhje me Nenin 65 të KPK.

237. Për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve Trupi Gjykses do ta dënonte **EK** me 1 vjet e 3 muaj burgim sipas KPK.

#### *Zbatimi i KPRK*

238. Sanksionet me gjobë maksimale prej 7,500 euro apo tridhjetë ditë deri në pesë vjet burgim aplikohen në këtë rast (Neni 374(1) i KPRK).

239. Rrethanat e lartcekura lehtësuese janë marrë parasysh dhe në konsideratë sipas Neneve 73 dhe 74 (3.6) dhe (3.10) të KPRK.

240. Për mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve Trupi Gjykses do ta dënonte **EK** me 2 muaj burgim sipas KPRK.



## *Përfundim*

241. KPRK është më i favorshëm se sa ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës. KPRK duhet të zbatohet në përputhje me Nenin 3(2) të KPRK. **EK** dënohet me dy muaj burgim në përputhje me Nenin 45 të KPRK.

### **12.5 Dënimi unik**

242. Që të dytë **MK** dhe **EK** kanë kryer vepra penale në bashkim.

243. Duke marr parasysh Nenet 3(1) dhe (2) të KPRK, KPK mbetet ligji më i favorshëm me të cilin caktohet limit prej maksimum 20 vjet burgim sipas Neni 71(2)(2) të KPK. KPRK, në anën tjetër, parasheh limitin prej 25 vjet burgim të dënimit për veprat në bashkim (Neni 80(2)(2.2)). Trupi Gjykses konsideron ligjin për dënimin të jetë diskret nga veprat materiale. Dispozitat e dënimit të secilit kod KPK apo KPRK mund të aplikohen sipas Neni 3 të KPRK madje edhe kur dënimet sipas KPK dhe KPRK duhet të përmbledhen bashkë.

244. Prandaj, dhe në përputhje me Nenin 71(2)(2) të KPK, dënimi unik për **MK** është 17 deri 20 vjet burgim dhe, sipas Neni 80(2)(2.2) të KPRK 17 deri 25 vjet.

245. Për **EK** dënimi është i njëjtë sipas të dy kodeve: 7 vjet deri 7 vjet e 2 muaj.

246. Dënimet unike për kryerësit e veprave, duke marrë parasysh se imazhi i përgjithshëm ofron vetëm veprat e bashkuara:

- **MK** dënohet me dënim unik prej njëzet (20) vjet burgim.
- **EK** dënohet me dënim unik prej shtatë(7) vjet e një (1) muaj burgim.

### **12.6. Arresti shtëpiak**

247. Trupi Gjykses vë në dukje se e tërë koha e kaluar në paraburgim apo arrest shtëpiak duhet të llogaritet në dënimin me burg apo gjobë (Neni 73(1) i KPK dhe Neni 83(1) i KPRK).

## **13. ÇËSH TJET TJERA**

### **13.1.Konfiskimi**

248. Armët e ndaluara do të konfiskohen dhe shkatërrohen sipas Nenet 274(3) të KPRK dhe Nenet 38(1) dhe (2) të Ligjit për Armët. Konfiskimi do të bëhet brenda afatit prej 15 ditësh nga koha kur Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë (Neni 38(1) i Ligjit për Armët).

249. Gjykata shfrytëzon lirinë e veprimt të saj për ta konfiskuar veturën Audi me targa 02-560-AJ. Kjo veturë ishte përdorur në kryerjen e veprave vrasje e rëndë dhe vrasje (Neni 60(1) i KPK).

### **13.2. Shpenzimet**

250. Shpenzimet duhet të urdhërohen kundër kryerësve të dënuar (Neni 102(1) i KPRK). Trupi Gjykues nuk ka mundësi që t'i përpjesëtojë shpenzimet duke u bazuar në lidhje me çdo akuzë në Aktakuzë. Të Pandehurit janë bashkërisht dhe veç e veç përgjegjës për shpenzimet e procedurës por kërkohet që ata të paguajnë shumën minimale prej 400 euro secili Neni 102(3) i KPRK).

### **13.3 Kërkesa pasurore**

251. Një kërkesë pasurore nga Palët e Dëmtuara është paraqitur gabimisht në Gjykatë. Për shkak të keqinterpretimit nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Palëve të Dëmtuara parashtresa nuk është shqyrtuar nga Trupi Gjykues gjatë këshillimit. Parashtresa është siguruar në gj. Shqipe në seancën e datës 18 Janar 2013. Përfaqësuesi i Autorizuar ka deklaruar se kjo ishte fjala e tij përfundimtare dhe e kishte dhënë një përmbledhje me gojë. Ai ka konfirmuar në Gjykatë se parashtresa nuk përmbante asgjë më tepër. Për këtë arsye, parashtresa nuk u lexua në gjyq të hapur dhe nuk u përkthye. Në asnjë moment Përfaqësuesi i Autorizuar nuk ia kishte tërhequr vëmendjen gjykatës për kërkesën pronësore. Kjo u zbulua vetëm pas këshillimit të Gjykatës.

252. Përveç kësaj asnjë provë nuk ishte e bashkangjitur apo referuar në parashtresën për kërkesën pasurore.

253. Në asnjë kohë ai nuk ka deklaruar shprehimisht se dokumenti përmbante kërkesën pasurore dhe kështu ka shkelur detyrimin e tij ndaj klientit nga Neni 81(3) i KPPK. Avokati është i detyruar që të paraqesë në mënyrën e duhur parashtresën dhe Gjykata nuk ka kurrfarë

detyrimi ta miratojë këtë obligim kur parashtrësja është e mangët dhe nuk është në dijeni për këtë.

254. Trupi Gjykes konsideron se mungesa e respektimit të Nenit 109(1) deri (3) të KPPK dhe çorientimi i Gjykatës nënkupton se kërkesa pasurore nuk është paraqitur në mënyrën e duhur dhe prandaj obligimi i Gjykatës nga Neni 111 (2) i KPPK për ta marrë atë në shqyrtim nuk është iniciuar.

255. Për arsyet e cekura më lartë çështja e kërkesës pasurore nuk është marrë në konsideratë në diapozitiv (Neni 396(4) i KPPK).

-----  
Nuno Madureira

Kryetar i Trupit Gjykses

Gjyqtar i EULEX-it

-----  
Roxana Comsa

Anëtare e Trupi Gjykses

Gjyqtare e EULEX-it

-----  
Katja Dominik

Anëtare e Trupi Gjykses

Gjyqtare e EULEX-it

-----  
John Gayer

Procesmbajtës

Zyrtar Ligjor Ndërkombëtar i EULEX-it

**MJETI JURIDIK: Të Pandehurit , avokatët e tyre mbrojtës, Prokurori, Palët e Dëmtuara apo Përfaqësuesi i Autorizuar i tyre kanë afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi për të paraqitur ankesë në përputhje me Nenet 380(1) dhe 381(1) të KPP. Çdo ankesë duhet të paraqitet në Gjykatën e shkallës së parë sipas Nenit 388(1) të KPP.**